

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5488
E martë, 29 maj 2018
çmimi 0.40 €

BE-ja: Kosova deri në shtator duhet ta zbatojë Agjendën për Reforma Evropiane



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

SHUMË E FORTË KJO OJQ E BASHKËSISË SË KOMUNAVE SERBE NË KOSOVË! F. 11



BEHXHET SH. SHALA - BAJGORA

VESELI: KOSOVA DHE KROACIA DO TA THELLOJNË PARTNERITETIN NË TË GJITHA FUSHAT F. 5

EMIGRANTI QË SHPËTOI KATËRVJEÇARIN FITON SHITËSINË FRANCEZE F. 12

EKONOMI

KOSOVA DHE MALI I ZI MERRN VESH PËR HEQJEN E TAKSËS KUFITARE F. 8

KONTRATAT E DËMSHME PËR TELEKOMIN DORËZOHEN TE KRIMET EKONOMIKE F. 9

KULTURË

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR RESTAURIMIN E QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT F. 13

SPORT

HALITI: PËR TROFE U RIKTHEVA TE PRISHTINA F. 14

SONTE VËLLAZËRORJA KOSOVË - SHQIPËRI F. 14

FLET PËR "EPOKËN E RE", ALI AHMETI

Zgjidhja e kontestit të emrit hap dyert e NATO-s dhe të BE-së për Maqedoninë

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, është shprehur i kënaqur me bashkëqeverisjen e deritanishme në Republikën e Maqedonisë. Ai ka thënë se gjatë kësaj periudhe Maqedonia ka shënuar progres dhe është në rrugën e duhur drejt anëtarësimit në NATO dhe në BE. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ahmeti ka deklaruar se prioriteti i koalicionit qeverisës është integrimi euroatlantik i cili garanton paqe, stabilitet dhe siguri në Maqedoni dhe rajon. Ai ka bërë me dije se zgjidhja e kontestit të emrit me Greqinë do t'i zhbllokojë dyert e NATO-s dhe të BE-së për Maqedoninë. Nëse kjo çështje përfundon me sukses, Ahmeti ka thënë se Maqedonia me automatizëm do të marrë ftesë për anëtarësim në NATO, si dhe në qershor mund t'i hapë negociatat për anëtarësim në BE.




KRYEMINISTRI I VENDIT, RAMUSH HARADINAJ, KA REAGUAR NDAJ BLOKIMIT TË PUNIMEVE NË RRUGËN DEÇAN - PLAVË

Haradinaj: Rruga që po riparohet në Deçan ka ekzistuar edhe më parë

Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se ekziston një keqkuptim rreth punimeve në rrugën Deçan - Plavë. Ai i

ka ftuar diplomatët e huaj, të cilët i kanë dhënë të drejtë Manastirit të Deçanit për bllokimin e punimeve në këtë rrugë,



që të shkojnë në vend të ngjarjes dhe të shohin se si rruga që po riparohet ka ekzistuar edhe më parë

Ministri Bytyqi pret rezultate më të mira këtë vit nga testi i maturës

7 700 nxënës kanë marrë pjesë të hënën në testin e maturës në rajonin e Ferizajt dhe të Gjilanit. Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë,

Shyqiri Bytyqi, gjatë vizitave që ua ka bërë disa shollave në këto dy komuna, ka thënë se pret rezultate më të mira këtë vit nga testi i maturës



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666



BE-ja: Kosova deri në shtator duhet ta zbatojë Agjendën për Reforma Evropiane

Agjenda për Reforma Evropiane duhet të zbatohet plotësisht nga institucionet e Kosovës deri në muajin shtator të këtij viti. Kështu ka deklaruar shefja e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Nataliya Apostolova, në tryezën "Agjenda për Reforma Evropiane (ERA): Sfidat dhe pritshmëritë". Ajo ka vlerësuar se Kosova ka nevojë për një reformë të vërtetë në fushën e zbatimit të ligjeve

më tani shumë gjëra janë realizuar, por ende mbetet shumë për t'u bërë. "Kemi ngritur zërin se dëshirojmë të kemi administratë të mirë me njerëz të duhur. Është me rëndësi që Kosova të fokusohet në punën e saj dhe ta bëjë implementimin e ERA-s deri në shtator të këtij viti. Procesi që po e bën Kosova në drejtim të BE-së varet nga zbatimi i MSA-së. Shumë gjëra janë realizuar, por duhet të jemi të motivuar ta vazhdojmë punën", është shprehur Apostolova.

Edhe ambasadorja e Holandës në Kosovë, Gerrie Willems, ka thënë se Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) duhet të zbatohet plotësisht deri në shtator. Ajo ka theksuar se Kosova duhet të bëjë reforma të fuqishme dhe gjithëpërfshirëse. "MSA dhe ERA janë dy gjërat kryesore. ERA ofron mundësi për përmirësimin e ligjit, investimeve, punësimin dhe arsimin. Jo të gjitha objektivat e ERA-s janë zbatuar. Jam

lumtur të shoh që për zbatimin e ligjit ka shkallë më të lartë të arritshmërisë. Ndryshimi i politikave është dhe duhet të mbetet dokument kyç për ecjen e Kosovës përpara. Është kruciale që Kosova t'i zbatojë reformat e dala nga ERA. Ky proces kërkon përkushtim politik dhe është në dorën tuaj. Me forcat e përbashkëta mund t'i arrijmë rezultatet konkrete. U bëj thirrje institucioneve që deri në shtator ERA-n ta realizojnë plotësisht. Presim nga Kosova përkushtim drejt reformave të fuqishme dhe gjithëpërfshirëse", ka theksuar Willems. Ndërsa ministria e Integritimit Evropian (MIE), Dhurata Hoxha, ka bërë me dije se institucionet e Kosovës kanë shënuar progres për realizimin e 22 prioritetëve të Agjendës për Reforma Evropiane (ERA). "Deri më tani ka progres të konsiderueshëm. Ky progres është avancuar sidomos pas miratimit të 11 ligjeve në

Kuvendin e Republikës së Kosovës. Sa i përket sundimit të ligjit, ndër të arriturat më të mëdha është miratimi i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe miratimi i ndryshimit të Ligjit për Prokurorinë e Shtetit. Në këtë drejtim, ka pasur progres edhe në një numër të prioritetëve", ka deklaruar Hoxha.

Ajo ka thënë se institucionet duhet të tregojnë përkushtim dhe seriozitet për zbatimin e prioritetëve dhe, sipas Hoxhës, Ministria e Integritimit Evropian është duke ndihmuar në këtë drejtim dhe po punon ngushtë me të gjitha institucionet për t'i zbatuar këto prioritetet. "Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, konkurrueshmëria dhe përmirësimi i klimës për investime, si dhe politikat më të avancuara të punësimin dhe arsimin të lartë, janë detyrat dhe obligimet tona karshi qytetarëve të vendit tonë", është shprehur Hoxha.

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 28 MAJ - Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Prishtinë, Nataliya Apostolova, ka thënë të hënën se Kosova ka nevojë për një reformë të vërtetë në fushën e zbatimit të ligjeve. "Tani është shumë e rëndësishme që Kosova të bëjë një listë të prioritetëve që lidhen me zbatimin e ligjeve. Kosova ka nevojë për një reformë të vërtetë në këtë aspekt. Kemi procese të shumta me rëndësi për liberalizimin e vizave. Ne

po punojmë së bashku në këtë aspekt", ka deklaruar Apostolova në tryezën me temën: "Agjenda për Reforma Evropiane (ERA): Sfidat dhe pritshmëritë" e organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Instituti GAP dhe Instituti i Prishtinës për Studime Politike.

Apostolova ka thënë se deri në shtator Kosova duhet ta zbatojë plotësisht Agjendën për Reforma Evropiane (ERA). Ajo ka vlerësuar se procesi që po bën Kosova në drejtim të BE-së varet nga zbatimi i MSA-së dhe, sipas Apostolovës, deri

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka reaguar ndaj bllokimit të punimeve në rrugën Deçan - Plavë

Haradinaj: Rruga që po riparohet në Deçan ka ekzistuar edhe më parë

Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se ekziston një keqkuptim rreth punimeve në rrugën Deçan - Plavë. Ai i ka ftuar diplomatët e huaj, të cilët i kanë dhënë të drejtë Manastirit të Deçanit për bllokimin e punimeve në këtë rrugë, që të shkojnë në vend të ngjarjes dhe të shohin se si rruga që po riparohet ka ekzistuar edhe më parë

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 28 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka reaguar të hënën ndaj bllokimit të asfaltimit të rrugës Deçan - Plavë. Ai ka pohuar se këtu ka një keqkuptim dhe ka ftuar diplomatët e huaj që kanë reaguar për këtë rast ta vizitojnë vendin dhe të binden se ajo rrugë ka ekzistuar edhe më parë. "Ekziston një keqinformim rreth punimeve në njërin nga rrugët e Deçanit. Ftoj diplomatët të shkojnë në vend të ngjarjes, ta shohin situatën dhe të binden se rruga që po rinovohet ka ekzistuar edhe më parë, për t'iu shmangur kështu deklarimeve të ngutshme", ka shkruar Haradinaj në profilin e

vet në "Facebook", duke shtuar se Qeveria që drejton e ka për obligim riparimin e rrugëve në tërë territorin e Kosovës. "Populli i Kosovës gjithmonë ka jetuar në harmoni me komunitetet pakicë, duke respektuar trashëgiminë religjioze dhe kulturore të të gjithëve pa dallim. Qeveria e Kosovës e ka për obligim riparimin dhe menaxhimin e rrugëve në tërë territorin e Kosovës", ka shkruar Haradinaj.

Edhe ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, është deklaruar për këtë çështje, duke thënë se më tepër është bërë politikë në lidhje me këtë rrugë. "Sa iu përket vështirësive që kemi me Manastirin, më tepër është bërë politikë. Ne jemi të vetëdijshëm për obligimet që i kemi marrë

sipas Planit të Ahtisaarit. Punimet janë duke u kryer jashtë zonës së mbrojtur. Është e vërtetë se është një ndërhyrje nga kompania që po kryen punimet, sepse aty vazhdimisht ka shembje të dheut, dhe ne duhet ta bëjmë të qasshme rrugën", ka thënë Lekaj në një konferencë për medie.

Kurse ish-kryetari i Komunës së Deçanit, Rasim Selmanaj, ka thënë për "Epokën e re" se në kohën sa ka qeverisur këtë komunë ka ekzistuar edhe një memorandum në mes të komunës dhe Manastirit për asfaltimin e kësaj rruge. "Fillimisht Manastiri është pajtuar të rregullohet kjo rrugë por, pasi që unë në atë kohë, sa isha kryetar komune, kam filluar të punoj, ka ndërhyrë përmes KFOR-it dhe i ka ndërprerë punimet. Pastaj i kam ftuar të gjithë faktorët relevantë dhe kemi bërë një memorandum me z. Sava Janjiqin për asfaltimin e rrugës ekzistuese në gjatësi 2.4 kilometra në zonën e mbrojtur. Kurse tani kur është dashur të vazhdohet kjo rrugë, ka penguar Manastiri, sepse është zonë e

mbrojtur", ka thënë Selmanaj. Ndaj veprimit të Manastirit ka reaguar të hënën edhe kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati. Në profilin e vet në "Facebook" ai ka shkruar se këtë problem Qeveria duhet ta zgjidhë urgjentisht. "Rruga Deçan - Plavë është jetike për shqiptarët që jetojnë në Plavë, Guci dhe trevat e tjera në Mal të Zi. Problemin e dalë me Manastirin e Deçanit, Qeveria duhet ta zgjidhë urgjentisht. Sidoqoftë, edhe kjo krizë dëshmon se korniza aktuale ligjore dhe kushtetuese e vështirëson funksionalitetin e shtetit të Kosovës. Në anën tjetër, Kishës Serbe, pakicës serbe, rrjedhimisht Serbisë, i jep privilegje të tilla, të cilat sa herë të duan e pengojnë këtë funksionalitet, qoftë edhe me pengimin e projekteve të tilla infrastrukturore. Manastiri i Deçanit dhe komuniteti fetar serb do të duhej të kuptonte se e vetmja mënyrë për avancimin e marrëdhënieve të mira me shqiptarët është njohja e realitetit dhe bashkëpunimi me ta në të mirën e dyanshme", ka shkruar Murati. Ai ka thënë se

ndërtimi i kësaj rruge e rrit vlerën kulturore e turistike edhe të Manastirit të Deçanit si një pasuri kulturore e njerëzimit. "Përndryshe, keqpërdorimi i privilegjeve të garantuara me ligje e Kushtetutë dhe zbatimi i tyre në dëm të shumicës, në realitet veç e vështirëson pajtimin në mes të popujve dhe pozitën e pakicës serbe në Kosovë", ka shkruar Murati.

Gjatë fundjavës Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) në Kosovë ka njoftuar se ka ndjekur me shqetësim, siç është thënë, "atë që duket të jetë ndërtim i paligjshëm i rrugëve, që po vazhdon brenda Zonës së Veçantë të Mbrojtjes të Manastirit të Deçanit".

Deklaratën e OSBE-së e ka mbështetur edhe ambasadori i ShBA-së në Prishtinë, Greg Delawie dhe shefja e Zyrës së BE-së në Prishtinë, Nataliya Apostolova. Ndërprerjen e punimeve fillimisht e ka kërkuar përfaqësuesi i Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, igumeni Sava Janjiq, i cili ka thënë se ndërtimi i kësaj rruge është i paligjshëm.



Flet për "Epokën e re", Ali Ahmeti

Zgjidhja e kontestit të emrit hap dyert



Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, është shprehur i kënaqur me bashkëqeverisjen e deritanishme në Republikën e Maqedonisë. Ai ka thënë se gjatë kësaj periudhe Maqedonia ka shënuar progres dhe është në rrugën e duhur drejt anëtarësimit në NATO dhe në BE. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ahmeti ka deklaruar se prioritet i koalicionit qeverisës është integrimi euroatlantik i cili garanton paqe, stabilitet dhe siguri në Maqedoni dhe rajon. Ai ka bërë me dije se zgjidhja e kontestit të emrit me Greqinë do t'i zhblllokojë dyert e NATO-s dhe të BE-së për Maqedoninë. Nëse kjo çështje përfundon me sukses, Ahmeti ka thënë se Maqedonia me automatizëm do të marrë ftesë për anëtarësim në NATO, si dhe në qershor mund t'i hapë negociatat për anëtarësim në BE

prioritet i koalicionit qeverisës është integrimi euroatlantik dhe, sipas Ahmetit, gjatë kësaj periudhe Maqedonia ka shënuar progres dhe është në rrugën e duhur drejt anëtarësimit në NATO dhe në BE. Ai ka bërë me dije se zgjidhja e kontestit të emrit me Greqinë do t'i zhblllokojë dyert e NATO-s dhe BE-së për Maqedoninë.

Nëse kjo çështje përfundon me sukses, Ahmeti ka thënë se Maqedonia me automatizëm do të marrë ftesë për anëtarësim në NATO si dhe në qershor mund t'i hapë negociatat për anëtarësim në BE. "Siç jeni në dijeni, jemi në një proces shumë të rëndësishëm drejt zgjidhjes së çështjes së emrit. Jemi drejt gjetjes së një kompromisi dhe pajtueshmërie me fqinjën tonë, Greqinë. I gjithë opinioni e di se tanimë pengesa e

vetme për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë në NATO është problemi i pazgjidhur me Greqinë. Kjo na paraqitet si pengesë edhe për hapjen e negociatave për anëtarësim të Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Kështu që, prioritet i kësaj qeverie ka qenë arritja e zgjidhjes së kontestit me Greqinë për shkak të emrit. Të gjitha palët jemi duke u angazhuar dhe duke kontribuar që sa më parë të mbyllet kjo temë, sepse kështu kontribuojmë për forcimin e paqes, stabilitetit dhe sigurisë. Kjo i kontribuon edhe anëtarësimit në NATO dhe hapjes së negociatave për anëtarësim në BE", ka deklaruar ai.

Ahmeti ka folur edhe për progresin që ka arritur komuniteti shqiptar në Maqedoni. Ai ka thënë se në këtë drejtim janë

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 28 MAJ - Lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, të hënë e ka quajtur të suksesshme punën e koalicionit qeverisës në Republikën e Maqedonisë. Në këtë intervistë

dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ka marrëveshje me partnerët e koalicionit për t'i shtyrë përpara temat që kanë të bëjnë me të ardhmen e vendit. "Ka zhvillime shumë më të mëdha se sa unë të ndalem tani të bëj një analizë për bashkëqeverisjen e deritashme. Megjithatë, në pika të shkurtra

mund të them se është një bashkëqeverisje e suksesshme dhe ka pajtim me partnerët e koalicionit për t'i shtyrë përpara temat serioze që kanë të bëjnë me të ardhmen e Republikës së Maqedonisë, si dhe që kanë të bëjnë me paqen dhe stabilitetin e rajonit në tërësi", është shprehur Ahmeti. Ai ka thënë se

e NATO-s dhe të BE-së për Maqedoninë

tani të bëj një analizë për bashkëqeverisjen e deritashme. Megjithatë, në pika të shkurtra mund të them se është një bashkëqeverisje e suksesshme dhe ka pajtim me partnerët e koalicionit për t'i shtyrë përpara temat serioze që kanë të bëjnë me të ardhmen e Republikës së Maqedonisë, si dhe që kanë të bëjnë me paqen dhe stabilitetin e rajonit në tërësi. Siç jeni në dijeni, jemi në një proces shumë të rëndësishëm drejt zgjidhjes së çështjes së emrit. Jemi drejt gjetjes së një kompromisi dhe pajtueshmërie me fqinjën tonë, Greqinë. I gjithë opinioni e di se tanimë pengesa e vetme për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë në NATO është problemi i pazgjidhur me Greqinë. Kjo na paraqitet si pengesë edhe për hapjen e negociatave për anëtarësim të Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Kështu që, prioritet i kësaj qeverie ka qenë arritja e zgjidhjes së kontestit me Greqinë për shkak të emrit. Të gjitha palët jemi duke u angazhuar dhe duke kontribuar që sa më parë të mbyllet kjo temë, sepse kështu kontribuojmë për forcimin e paqes, stabilitetit dhe sigurisë. Kjo i kontribuon edhe anëtarësimit në NATO dhe hapjes së negociatave për anëtarësim në BE. Dhe kjo është edhe në dobi të Kosovës, si dhe tërë rajonit të Ballkanit Perëndimor.

"Epoka e re": Kontesti i emrit në mes të Maqedonisë dhe Greqisë mund të zgjidhet para pushimeve verore?

Ahmeti: Mendoj se të gjitha palët janë në pritje që kjo çështje të zgjidhet sa më parë dhe që pushimet të jenë të qeta dhe jo me ngarkesën që e kemi pasur deri më tani.

"Epoka e re": Kjo çështje është pengesa kryesore për avancimin e Maqedonisë drejt NATO-s dhe BE-së?

Ahmeti: Barrkada kryesore është çështja e zgjidhjes së emrit, por sigurisht ka edhe kërkesa të tjera. Mirëpo, ato do të hapen kur do të hapet kapitulli 23 dhe 24 sa i takon hapjes së negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Kurse sa i takon NATO-s, me zgjidhjen e këtij problemi Republika e Maqedonisë me automatizëm merr ftesë për anëtarësim në NATO. Kjo na është konfirmuar se kur do të zgjidhet problemi me kontestin e emrit Maqedonia do të marrë ftesë për NATO. Pas marrjes së ftesës për anëtarësim në NATO pritet ratifikimi i kësaj marrëveshje nga vendet anëtare të NATO-s.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh progresin e shënuar gjatë kësaj periudhe qeverisëse, prisni që në qershor të hapen negociatat për anëtarësim?

Ahmeti: Nëse përfundon me sukses zgjidhja e emrit, pra arrihet kompromis në mes të palëve, nuk përjashtohet mundësia që në qershor të hapen negociatat për anëtarësim.

"Epoka e re": Maqedonia ka qenë më mirë ndonjëherë si shtet sesa tani?

Ahmeti: Gjithmonë ka hapësirë për më mirë, mirëpo mendoj se Maqedonia ka bërë progres ditët e fundit dhe assesi nuk duhet të ndalet ky progres.

"Epoka e re": Jeni i kënaqur me progresin e komunitetit shqiptar?

Ahmeti: Ka edhe shumë për t'u bërë, mirëpo deri më tani janë

bërë punë shumë të mëdha për shqiptarët në Republikën e Maqedonisë. Nuk duhet të vetëkënaqemi sepse ka edhe shumë për t'u bërë. Tani jam në presion të kohës. Nuk kam mundësi t'i numëroj të gjitha të arriturat dhe progresin që kanë arritur shqiptarët në Republikën e Maqedonisë, por do t'i them dy-tri gjëra. Shqiptarët në Maqedoni kanë flamurin e vet kombëtar shqiptar, kanë dy universitete shtetërore shqiptare, një në Tetovë dhe një në Shkup, kanë policët dhe ushtarët e vet. Po ashtu, është çështje kohe se kur do të dekretohet Ligji për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe dhe kur do të hyjë në fuqi. Kemi një kontest me presidentin e shtetit i cili nuk e dekreton këtë ligj, por kjo është çështje kohe, sepse ai ligj nuk kthehet pas. Kemi pritur shumë, na ka mbetur edhe pak për të pritur

që ligji të hyjë në fuqi dhe që shqipja të përdoret në të gjitha nivelet qendrore dhe lokale.

"Epoka e re": Z. Ahmeti, është paralajmëruar se shumë shpejt do të mbahet mbledhja e përbashkët Maqedoni - Kosovë. Keni informacione se kur saktësisht do të mbahet kjo mbledhje dhe cili do të jetë qëllimi i saj?

Ahmeti: Republika e Maqedonisë ka më së shumti marrëveshje të bashkëpunimit ndërshtetëror të nënshkuara me Republikën e Kosovës. Këto marrëveshje janë në fushën e ekonomisë si në fushën e bashkëpunimit të institucioneve. Kurse sa i përket mbledhjes së përbashkët, pres që të mbahet së shpejti meqë autoritetet e dy vendeve janë duke punuar për këtë. Është çështje kohe dhe besoj shumë shpejt se do të marrë epilog kjo çështje.

Veseli: Kosova dhe Kroacia do ta thellojnë partneritetin në të gjitha fushat

PRISHTINË, 28 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të hënën në takim Grupin e Miqësisë Kosovë - Kroaci të parlamentit kroat, i cili po qëndron për vizitë në vendin tonë. Në takim u bisedua për zhvillimet aktuale politike në vendin tonë, për marrëdhëniet midis dy vendeve mike dhe parlatenteve respektive. Kryeparlamentari Veseli ka çmuar lart bashkëpunimin që Kuvendi i Kosovës dhe Parlamenti kroat kultivojnë midis tyre, në funksion të forcimit të miqësisë ndërmjet dy vendeve dhe popujve, si dhe të ngritjes së kapaciteteve të Kuvendit në shumë segmente. Kreu i Kuvendit e konsideroi të rëndësishme përvojën parlamentare kroate, sidomos atë të

procesit të integritimit evropian të Kroacisë, të cilat, sipas tij, mund t'i shërbejnë Kosovës për forcimin e mëtejshëm të demokracisë parlamentare dhe lehtësimit të rrugëtimit eurointegruës. Veseli ka theksuar nevojën e një bashkëpunimi më të ngushtë midis Kosovës dhe Kroacisë në fushën e investimeve ekonomike. Deputetët e Saborit, anëtarë të Grupit të Miqësisë me Kosovën, theksuan se vizita e tyre në Kosovë është pikërisht në funksion të forcimit të miqësisë e të bashkëpunimit midis dy vendeve, ndërsa konfirmuan gatishmërinë dhe përkushtimin e shtetit kroat për ta vazhduar mbështetjen ndaj Kosovës në të gjitha drejtimet. Grupet e Miqësisë Kosovë - Kroaci kanë zhvilluar edhe një

takim të përbashkët. Takimin e hapi përfaqësuesi i Grupit të Miqësisë Kosovë - Kroaci, Avdullah Hoti, i cili, pasi ka përsëndetur homologët kroatë, ka thënë se Kosova dhe Kroacia vazhdojnë në një miqësi të kahershme si në vëshitërisht ashtu edhe në paqe. Kryetari i grupit të miqësisë nga parlamenti kroat, Andrija Mikulić, ka theksuar se ekziston një traditë e mirë bashkëpunimi midis dy vendeve. "Kroacia ka krijuar tashmë një përvojë të mirë dhe mund ta transmetojë te Kosova, sidomos në marrëdhëniet parlamentare", ka thënë Mikulić. Ai ka shtuar se miqësia e dy popujve është një miqësi që buron nga një forcë e madhe, e cila është përcaktim i qartë i rrugës së përbashkët drejt Bashkimit Evropian.



bërë punë të mëdha, por ende mbetet shumë për t'u bërë. Lideri i BDI-së ka theksuar se hyrja në fuqi i ligjit për përdorimin e gjuhës shqipe është çështje kohe. "Shqiptarët në Maqedoni kanë flamurin e vet kombëtar shqiptar, kanë dy universitete shtetërore shqiptare, një në Tetovë dhe një në Shkup, kanë policët dhe ushtarët e vet. Po ashtu, është çështje kohe se kur do të dekretohet Ligji për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe dhe kur do të hyjë në fuqi", ka thënë Ahmeti.

"Epoka e re": Z. Ahmeti, çfarë vlerësimi keni për punën e koalicionit qeveritar dhe sa jeni të kënaqur me këtë bashkëqeverisje?

Ahmeti: Ka zhvillime shumë më të mëdha sesa unë të ndalem

Haradinaj i ofron bashkëpunim Komunës së Prizrenit

PRIZREN, 28 MAJ (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vizituar të hënën Komunën e Prizrenit, ku është takua me kryetarin e kësaj komune, Mytaher Haskuka. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se është këtu, në njërin nga qendrat më të mëdha në Kosovë, për ta mësuar nga afër gjendjen reale dhe parë se cilat janë detyrat e Qeverisë së Kosovës për zhvillimin e mëtejshëm të këtij qyteti. Haradinaj ka thënë se duhen hequr pengesat kësaj komune, që të mund të kalojë në një plan urbanistik dhe zhvillimor, njëkohësisht duhet dhënë përkrahja për t'i pasur në shfrytëzim hapësirat për një park industrial. "Jemi optimistë se do të jetë nxitje për një zhvillim ekonomik dhe jemi të gatshëm të ecim në etapa të tjera me parkun industrial, zgjidhjen e çështjes së pronësisë dhe që t'i mundësohet komunës të ecë përpara", është shprehur kryeministri Haradinaj.

Ai ka theksuar se gjatë takimit me kryetarin Haskuka është diskutuar për shumë tema që duhen trajtuar me seriozitetin më të lartë si, arsimin, shëndetësinë, rendin, ku ka specifikuar çështjen e narkotikëve dhe shpërndarjen e tyre nëpër shkolla. "E sigurova kryetarin Haskuka që Qeveria e vendit pa asnjë hezitim do t'i kryejë ato që janë punë të Qeverisë", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke potencuar se komuna nuk duhet të jetë e bllokuar për shkak se niveli nacional nuk po i kryen punët e veta.

Nga ana e tij, kryetari Haskuka, pasi ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për vizitën dhe gatishmërinë për ta ndihmuar Komunën e Prizrenit, përmendi disa sfida si, parkingjet për vetura, mungesën e ujit të pijshëm në disa zona dhe ndërtimin e institucioneve parashkollore, për të cilat mori premtimin e kryeministrit Haradinaj për mbështetje.



Bahtiri kërkon zbatimin e ligjit në Mitrovicë



MITROVICË, 28 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka kërkuar nga drejtorët komunalë të angazhohen maksimalisht për realizimin e planeve të punës, në mënyrë që të ofrohen shërbime sa më cilësore për qytetarë. Po ashtu, ai ka kërkuar të zbatohet ligji në këtë komunë. "Rend dhe rregull duhet të ketë në administratën komunale. Zbatimi i ligjit është parakusht esencial për efikasitet në punë dhe për ofrimin e shërbimeve për qytetarë. Jam i

vendosur dhe në asnjë mënyrë nuk do të lejoj që në Komunën e Mitrovicës të ketë anarki dhe moszbatim të ligjit. Kjo vlen edhe për lëshimin e lejeve për ndërtim, që do të thotë se nuk ka më ndërtim pa leje pa i plotësuar kriteret e ndërtimit", ka thënë Bahtiri në mbledhjen e Bordit të drejtorëve. Në këtë mbledhje është biseduar edhe për fabrikën e përpunimit të gomave, së cilës i është ndërprerë prodhimi nga inspektorët komunalë për shkak të mungesës së lejeve adekuate për punë.

Komuna e Malishevës fillon përgatitjet për shënimin e Ditës së Çlirimit

Malishevë, 28 maj (ER) - Komuna e Malishevës ka filluar përgatitjet për shënimin e 16 qershorit, Ditës së Dëshmorëve dhe Ditës së Çlirimit të Komunës së Malishevës. Kështu është thënë në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, i drejtuar nga kryetari i Malishevës, Ragip Begaj. Në këtë mbledhje kryetari Begaj ka kërkuar mos të ketë vonesa në

implementimin e planifikimeve të komunës, sidomos në realizimin e projekteve kapitale. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport tashmë i ka filluar përgatitjet për shënimin e 16 qershorit dhe se është duke punuar maksimalisht që kjo datë me rëndësi për Malishevën të shënohet në mënyrën më të mirë të mundshme.



Komuna e Prizrenit i jep 35 mijë euro për strehimore të qenve



PRIZREN, 28 MAJ (ER) - Komuna e Prizrenit ka ndarë 35 mijë euro për ndërtimin e një strehimore për qentë endacakë. Lajmin e ka bërë me dije kryetari i kësaj komune, Mytaher Haskuka, me anë të një postimi në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se me iniciativën e

Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë ka filluar projekti për menaxhimin dhe kontrollin e qenve endacakë, i cili përfshin gjithë territorin e Kosovës dhe do të zgjasë gjatë gjithë vitit.

Haskuka ka treguar se për këtë projekt do të kujdesen gjashtë kompani të

ndryshme për rajonin e Prizrenit dhe komunat përreth, buxheti i të cilit është 67 500.00 euro dhe parasheh zënie të qenve, mjekimin, kastrimin, sterilizimin dhe në raste të veçanta, ofrimin e shërbimeve të tjera shtesë, në përputhje me ligjin për përkujdesjen e kafshëve.

Gjykata Themelore shpall të pafajshëm Salih Mekajn

PRISHTINË, 28 MAJ - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur të pafajshëm ish-kryetarin e Gjykatës së Apelit, Salih Mekaj, i cili ishte akuzuar për veprën

penale ushtrim të ndikimit. Të pafajshëm janë shpallur edhe Vlora Gorani dhe Mentor e Ali Seferaj, të cilët ishin akuzuar për veprat penale shtytje në

kryerjen e ushtrimit të ndikimit dhe dhënie të ryshfetit. Gjykata ka marrë aktgjykim lirues, pasi ka konstatuar se, në bazë të Kodit Penal të

Republikës së Kosovës, gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat janë ngarkuar.



Ministri Bytyqi pret rezultate më të mira këtë vit nga testi i maturës

7 700 nxënës kanë marrë pjesë të hënën në testin e maturës në rajonin e Ferizajt dhe të Gjilanit. Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, gjatë vizitave që ua ka bërë disa shkollave në këto dy komuna, ka thënë se pret rezultate më të mira këtë vit nga testi i maturës

Ferizaj ka thënë se rezultatet të cilat do të dalin nga ky test janë kontribut i mësimdhënësve dhe menaxherëve të shkollave, duke pasur edhe përkrahjen nga kryetarët e komunave dhe nga Ministria e Arsimit.

Bytyqi ka pohuar se vizita në Ferizaj është bërë me qëllim për ta parë nga afër procesin e testimit dhe për të marrë informata nga drejtori i DKA-së për rrjedhën e mbajtjes së testit. "Ne presim rezultatet më të mira, sepse konsiderojmë se këtë vit ka qenë një angazhim i përgjithshëm. Kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë me nivelin lokal dhe kjo ka ndikuar që përgatitjet në përgjithësi për këtë vit të jenë më të mira dhe presim rezul-

tate më të mira", ka thënë Bytyqi.

Ndërsa gjatë vizitës në Gjilan ministri Bytyqi ka theksuar se procesi i testimit ka shkuar ashtu siç është planifikuar. Ai ka shprehur besimin se rezultatet e testit të maturës këtë vit do të jenë më të mira.

Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka falënderuar ministrin Bytyqi që ka qëndruar në Ferizaj për të parë nga afër procesin e testit të maturës, në një shkollë elitare në Ferizaj, siç është gjimnazi "Kuvendi i Arbrit". Aliu ka thënë se procesi i testimit është zhvilluar shumë qetë dhe në kushte shumë të mira. Ai ka uruar që nxënësit të kenë sukses, duke u zotuar se si kryetar komune do të punojë

për të krijuar kushte dhe mundësi për nxënësit, i bindur se hapat të cilët ka ndërmarrë komuna së bashku me Ministrinë e Arsimit do të shpijnë drejt cilësisë dhe efekteve konkrete të përmirësimit të cilësisë në arsim.

Ndërsa kryetari i Komunës së Gjilanit, Lufti Haziri, ka thënë se testi i maturës shënon një ditë të veçantë për nxënësit dhe komunën e Gjilanit. Haziri ka theksuar se ky test ka filluar jashtëzakonisht mirë dhe se nuk është shënuar asnjë incident, kopje apo fotografi që ka dalë jashtë shkollave. Në gjithë Kosovën janë 27 700 nxënës të kësaj gjenerate. Rezultatet e testit të maturës priten të dalin deri më 1 qershor.

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

FERIZAJ, 28 MAJ - Testi i Maturës Shtetërore 2018 është mbajtur të hënën në rajonin e Ferizajt dhe të Gjilanit, komuna këto që janë përzgjedhur për të filluar këtë proces të rëndësishëm me short publik, ndërsa matura shtetërore do të vazhdojë edhe për tri ditë në rajonet e tjera të

Kosovës.

Për ta parë nga afër mbarëvajtjen e testit në këto dy komuna, ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka vizituar shkollën "Kuvendi i Arbërit" në Ferizaj dhe shkollën "Xhavit Ahmeti" në Gjilan, ku është shoqëruar nga kryetarët e komunave, Agim Aliu dhe Lufti Haziri.

Ministri Bytyqi gjatë vizitës në



Deputetja Emilija Rexhepi i bashkohet AAK-së

PRISHTINË, 28 MAJ (ER) - Deputetja e Kuvendit të Kosovës, Emilija Rexhepi, të hënën është bërë pjesë e grupit parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Lajmin e ka bërë me dije deputeti i AAK-së, Muharrem Nitaj. Ai ka thënë se

Emilija Rexhepi është një prej deputeteve më të përgjegjshme të Kuvendit të Kosovës. Nitaj ka thënë se ardhja e saj në AAK është shenjë e rritjes së grupit parlamentar. "Një mundësi më shumë që zëri ynë të jetë edhe më i fortë në Kuvend.

Njëkohësisht edhe mbështetje më e madhe për Qeverinë Haradinaj", ka thënë Nitaj me rastin e aderimit të deputetes Rexhepi në AAK.

Me deputeten Emilija Rexhepi grupi parlamentar i AAK-së bëhet me 12 deputetë.



Kosova dhe Mali i Zi merren vesh për heqjen e taksës kufitare

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka pritur të hënën në takim ministrin e Transportit dhe Çështjeve Detare të Malit të Zi, Osman Nurković, me të cilin kanë biseduar për një sërë temash dhe projektsh bashkëpunimi në infrastrukturën rrugore, ajrore dhe hekurudhore



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 28 MAJ - Qeveria e Kosovës dhe ajo e Malit të Zi janë duke rishikuar disa politika të rritjes së bashkëpunimit shtetëror, ndër to edhe mundësinë e heqjes së taksës kufitare. Kështu është bërë me dije të hënën pas takimit që pati ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, me ministrin e Transportit dhe Çështjeve Detare të Malit të Zi, Osman Nurković. Ata në takimin e përbashkët në Prishtinë kanë diskutuar për disa projekte bashkëpunimi në infrastrukturën rrugore, ajrore dhe hekurudhore.

Ministri i Transportit dhe Çështjeve Detare të Malit të Zi, Osman Nurković, gjatë një konference për medie ka treguar se me Lekajn kanë biseduar për shumë projekte të cilat duhen realizuar në të ardhmen. "Projekti më me rëndësi të cilin shpresoj ta fillojmë shumë shpejt është projekti madhor i ndërtimit të

tunelit Pejë - Rozhajë. Për këtë projekt kemi biseduar që një vit e gjysmë dhe kemi arritur ta kemi përkrahjen e qeverive tona, pra ka arritur në nivel të dy kryeministrave tanë dhe shpresojmë që fillojmë sa më parë", ka thënë ministri malazez.

Nurković ka thënë se tema e dytë që kanë diskutuar me Lekajn ishte projekti i rrugës Deçan - Plavë, që është edhe lidhja e dytë mes dy vendeve. "Po ashtu, kemi biseduar edhe për lidhjen hekurudhore ndërmjet Pejës dhe Rozhajës. Ne e kemi kryer projektin ideor për ndërtimin e kësaj pjese dhe do t'ia dorëzojmë këtë plan ideor Qeverisë së Kosovës dhe ministrin Lekaj. Një temë tjetër për të cilën kemi biseduar është edhe mundësia e heqjes së taksës kufitare ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës, sepse këtë e kemi identifikuar si një barrierë e cila i pengon bizneset dhe besoj se shumë shpejt do ta mënjanojmë, ku edhe për këtë çështje kemi përkrahjen e të dy kryeministrave tanë", ka

thënë Nurković, duke shtuar se kjo, përveçse do ta rriste qarkullimin e qytetarëve në të dyja anët e kufirit, gjithashtu do t'i ngruhe në nivel edhe më të lartë marrëdhëniet mes dy shteteve. "Ne biseduam edhe për nënshkrimin e marrëveshjes së transportit, ku bashkëpunëtorët tanë do të punojnë në këtë marrëveshje, të cilën

presim ta nënshkruajmë gjatë muajit korrik. Marrëdhëniet e shkëlqyeshme politike që i kemi, natyrisht se do t'i avancojmë edhe më tej në të ardhmen", ka thënë ministri Nurković.

Ndërkaq ministri Lekaj ka thënë se kjo vizitë e Nurkovićit tregon bashkëpunimin e mirë mes dy qeverive, asaj të Malit të

Zi dhe asaj të Kosovës. "Ajo që ne u morëm vesh sot, është që ta zhvillojmë infrastrukturën rrugore, hekurudhore dhe heqjen e taksës kufitare. Sa i përket tunelit Pejë - Rozhajë tani po bëhet studimi i fizibilitetit me intensitet të shtuar dhe nuk do të mbetet vetëm në fjalë, por do të implementohet me përpikëri", ka thënë Lekaj.

Shtyhet afati i implementimit të kodit të ri +383

PRISHTINË, 28 MAJ - Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) ka marrë vendim që zbatimi i kodit telefonik +383 të shtyhet deri më 31 tetor të këtij viti.

Zbatimi i plotë i këtij kodit ka qenë i paraparë të nisë më 30 qershor.

Kreshnik Gashi, kryetar i Bordit të ARKEP-it, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se vendimi për shtyrje është marrë pas kërkesave të operatorëve të telefonisë mobile dhe fikse që veprojnë në tregun e Kosovës, "VALA" dhe "IPKO". "Telekomi i Kosovës nuk ka pasur mundësi, sipas tyre, ta realizojë zbatimin, për shkak të mungesës financiare që ka. Operatori 'IPKO' e ka përfunduar një pjesë të madhe të zbatimit, por ka kërkuar më tepër kohë për heqje të plotë të kodit +386 nga funksioni", ka thënë Gashi. Sipas tij, operatorët që nuk e kanë përfunduar zba-

timin e kodit +383 në rrjetet e telefonisë fikse obligohen që brenda afatit kohor prej 30 ditësh të përfundojnë këtë proces.

Kodi shtetëror telefonik i Kosovës është ndarë në dhjetor të vitit 2016 nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve (ITU). Ky kod ishte rezultat i bisedimeve në Bruksel ndërmjet delegacionit të Kosovës dhe të Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Kodi shtetëror i Kosovës +383 ka filluar të zbatohet nga aplikacione të ndryshme. Aktualisht në Kosovë operojnë tre operatorë të telefonisë mobile dhe fikse të cilët shfrytëzojnë kode të huaja ndërkombëtare. Telefonia mobile "VALA" shfrytëzon kodin e Monakos (+377), ajo e "IPKO"-s kodin e Sllovenisë (+386), kurse telefonia fikse shfrytëzon kodin e Serbisë (+381).





Kontratat e dëmshme për Telekomin dorëzohen në krimet ekonomike

Trembëdhjetë kontrata me anekse, gjashtë prej tyre janë kontrata milionëshe nga periudha 2009-2018, janë dorëzuar të hënën në Drejtorinë e Krimeve Ekonomike në Prishtinë nga sindikalistët e Telekomit të Kosovës. Kryetari i Federatës Sindikale të PTK-së, Lahim Balaj, ka thënë se këto kontrata janë të dëmshme për Telekomin dhe, si të tilla, janë shkaktare të gjendjes aktuale në të cilën ndodhet kjo ndërmarrje

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 MAJ - Kryetari i Federatës Sindikale të PTK-së Lahim Balaj, të hënën ka dorëzuar në Departamentin e Krimeve Ekonomike në Prishtinë disa kontrata në bazë të të cilave pretendohet se është keqpërdorur dhe menaxhuar deri më tani Telekomit i Kosovës. Pas dorëzimit të këtyre kontratave, Balaj ka dhënë një deklaratë për medie. Ai ka bërë me dije se kontratat që ka dorëzuar janë milionëshe që,

sipas tij, e kanë sjellë në kolaps Telekomin e Kosovës. "Sot dorëzuar në Departamentin e Krimeve Ekonomike gjashtë kontrata milionëshe të cilat besojmë se janë të dëmshme dhe e kanë sjellë Telekomin në këtë gjendje. Janë gjashtë kontrata milionëshe dhe 13 aneks kontrata. Besojmë fuqishëm se duhet të zbardhen të gjitha ato që i kanë ndodhur Telekomit të Kosovës, duke e sjellë në këtë gjendje", ka thënë Balaj. Balaj nuk ka treguar saktësisht se për çfarë kontratash bëhet fjalë pasi, sipas tij, këtë do t'ia lë Departamentit të Krimeve

Ekonomike. Sipas Balajt, këto kontrata kanë të bëjnë për periudhën e viteve 2009-2018. "Për shkak të hetimeve nuk mund t'i bëjmë publike por, siç dihet, një ndër to është edhe kontrata me Z-Mobile", ka thënë ai. Balaj ka shtuar se nuk është në rregull që në bazë të dëmeve që janë shkakuar deri më tani, të mendohet në ulje të pagave të punëtorëve. Ai ka theksuar se edhe po të ulen pagat e punëtorëve 100 për qind, përsëri nuk mund të kthehet gjendja e mëparshme në ndërmarrje, pa u zbardhur të gjitha keqmenaxhimet.

'IPKO'-ja përkrah fëmijët me aftësi të kufizuara



PRISHTINË, 28 MAJ (ER) - Operatori "IPKO" ka filluar shpërndarjen e donacioneve për dhjetë qendra të cilat merren me fëmijët me aftësi të kufizuara. Sipas një njoftimi të "IPKO"-s, nga ky donacion do të përfitojnë pesë qendra burimore dhe pesë organizata. "Nga ky donacion do të përfitojnë: Qendra burimore për fëmijët me dëmtime intelektuale 'Përparimi' në Prishtinë, 'Lef

Nosi' në Prizren, 'Nënë Tereza' në Mitrovicë, Qendra burimore për fëmijët me dëmtime në të parë 'Xheladin Deda' në Pejë, Shkolla peciale për fëmijët me dëmtime të shumëfishta 'Shpresa' në Shtime, organizata 'Pema' në Ferizaj, 'Down Syndrome Kosova' në Prishtinë, 'Shoqata Autizmi' në Lipjan, Shoqata e të Shurdhërve në Prishtinë dhe organizata 'Handikos' në

Suharekë", është bërë me dije në njoftimin e "IPKO"-s. "IPKO"-ja i ka përkrahur të gjitha këto organizata me një shumë prej 10 000 eurosh. Donacioni është dhuruar, duke marrë për bazë nevojat e këtyre qendrave, duke i pajisur ato me materiale konkrete/didaktike, mjete dhe pajisje që lehtësojnë dhe ndihmojnë procesin e mësimnxënies midis fëmijëve me aftësi të kufizuara.

"IPKO"-ja vazhdimisht ka iniciuar dhe përkrahur kauza që ndërlidhen me fëmijët me aftësi të kufizuara. "Çdo fëmije duhet t'i ofrohen mundësi dhe burime të mjaftueshme zhvillimi dhe mësimnxënies dhe kjo nismë ka për qëllim t'i ndihmojë fëmijët dhe mësimdhënësit që këto qëllime të arrihen më lehtë", ka thënë Robert Erzin, drejtor ekzekutiv i "IPKO Telecommunications LLC".

Bëhet me dije se "IPKO"-ja ka dhuruar 100 000 euro pajisje mjekësore për dhjetë qendra të mjekësisë familjare në fund të vitit 2017 dhe në fillim të vitit 2018. Po ashtu, "IPKO"-ja ka përkrahur edhe sektorin e arsimit përmes projektit "Mësuesit zgjedhin IPKO-n", duke mbështetur 50 shkolla, kopshte dhe njësi të tjera arsimore, kryesisht në vendet rurale.

SHUMË E FORTË KJO OJQ E BASHKËSISË SË KOMUNAVE SERBE NË KOSOVË!



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Mashtrimi bëhet art, nga mashtruesit profesionistë: Serbët e Kosovës, që trupin e kanë në Kosovë e kokën në Serbi, ç'është e vërteta, kanë pasur nevojë ta kenë një OJQ të fortë e cila nuk do të kishte nevojë që për çdo gjë të pyetet Beogradi. Kosova, si shtet i pavarur që e kontrollon integritetin territorial 100 % sikur që e shtrinë sovranitetin në çdo milimetër ku kanë jetuar apo jetojnë shqiptarët, madje edhe paraardhësit e tyre, nga Ballkani e deri te Pakistani (hundëzakët e Ademit), është treguar shumë bashkëpunuese për formimin e një OJQ-je serbe. Kumbur më të mirë për këtë nuk kanë mundur ta gjejnë se në figurën e Presidentit Post-Historik, Shkëlqesisë së Tij, Lartmadhërisë, Censorit të Përgjithshëm, Kryeprokurorit të Shtetit, Kryegjykatësit, Guvernatorit të Shtetit, Komandantit të Përgjithshëm të FSK-së, Shefit të AKI-së, Kryepolicit dhe posteve të tjera që, për shkaqe praktike, teknike dhe, sidomos higjienike, nuk po i përmendi, Zotëri Hashim Thaçi. Hashimi ka përvojë të gjatë me OJQ-të sepse Kosovën e ka konsideruar dhe e konsideron si një organizatë joqeveritare, varësisht nga zhvillimet politike. Me vete si shoqëruar të së keqes i ka pasur edhe dy ish ojëqëistë, tash të veshur me pozita të pushtetit sikur që janë postet e ministrit, poste që u ishin rezervuar edhe në kohën kur nuk siguruan vota për vazhdimin e udhëtimit pas gjurmëve të Shefit. Njëri, si ministër që do të duhej të tregonte rrugën drejt Europës apo Evropës, pasi i përfunduan

rrenat dhe mashtrimet, u shndërrua në bartës të çantave, çadrave apo kondomëve për Udhëheqësin Shpirtëror (nuk e kuptoj si i pashpirti mund të bëhet udhëheqës shpirtëror!!!!) kurse tjetri, pasi e forcoi analfabetizmin intelektual, si ministër që duhej ta shpërndante arsimin, kaloi në një post tjetër që e përfaqëson Kosovën në botën e jashtme dhe, në të njëjtën kohë, kishte disa poste. Edhe ky njëri dhe pranohet si mashtrues dhe rrenc i certifikuar dhe i noterizuar te Shefi i Madh. I pari është besnik i Hashimit dhe gjithnjë afër Hashimit, kurse i dyti është gjithashtu besnik i Hashimit dhe gjeografikisht afër Kadrisë, si pykë e Hashimit! Në kushte normale këta e kanë vendin tjetërkund, në kushte jonormale janë afër dhe në mbrojtje të Hashimit. Derisa Hashimi të jetë potent dhe të ketë nevojë për ta, si çka, e lë në imagjinatën tuaj, lexues të nderuar! Këta edhe sot e përkrahin që Hashimi të jetë kryenegociatori i Kosovës me Vuçiçin dhe ku Kosova do të duhej të merrte vendime të vështira, të bëjë kompromis dhe, mbase se i dhimbet Vuçiçi, thotë se as Serbia nuk do ta ketë lehtë thuaja se ne i paskemi borxh Serbisë! A është kjo kërkimfalja e Hashimit, si kusht simbolik për t'u pajtuar me Serbinë për çka po e formon një Komision për të "Vërtetën" dhe Pajtimin e që, në këtë drejtim, si mercenar është angazhuar një ndërkombëtar, ndonëse thuhet se pronësia e këtij procesi është vendore. Për ta kompletuar këtë treshe mashtruese dhe për ta respektuar kuotën e përfaqësimit gjinor, gjithsesi duhet të përmendet edhe bredharakja e Brukselit, tashmë si fantazmë, mashtruesja dhe stjuardesa në linjën Prishtinë - Bruksel që ka trashur konton bankare dhe që e ka instaluar nepotizmin dhe e cila po thotë se Hashimi është mençuria e negociimit, prandaj mbetet i pakontestuar në këtë proces krejt me shpresën se Hashimit i ka mbetur edhe ndonjë asht rezervë i cili, edhe nëse nuk ka mish (para të majme), i ka mbetur shija e mishit (pak

para). Lypësaria dhe nënshtrimi nuk shërohen, sidomos kur ato bëhen kronike apo mënyrë e mbijetesës. Nuk mbahet mend që një OJQ të ketë nxitur përkrahjen ndërkombëtare dhe të jetë bërë subjekt ndërkombëtar sikur kjo OJQ e Serbisë e quajtur Bashkësia e Komunave Serbe. Si kusht për regjistrim të kësaj OJQ-je është dashur të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare në Bruksel dhe ky është rasti i parë, sigurisht edhe i vetëm kur një "OJQ" trajtohet si një çështje me rëndësi ndërkombëtare. Gjykata Kushtetuese e Kosovës i evidentoi 23 shkelje të Kushtetutës për këtë OJQ (aq të goditura mori Cezari nga Bruti dhe Kasi kur u vra në Senatin e Romës) mirëpo, doli me një përfundim idiotesk; ka aq shkelje, por se duhet të vazhdohet me themelimin e këtij mini shteti brenda Kosovës! Në vendet normale edhe për një shkelje të vetme të Kushtetutës anulohet çdo përpjekje tjetër sikur që merren masa ndaj atyre që kontribuuan për këtë gjendje! Te ne ata që e miratuan këtë interpretim idiotesk biseksual juridik (sigurisht e kanë shkruar të huajt), po përparojnë në pozita, si kuislingë e jo si profesionistë! Tash kriminelët e luftës dhe kriminelët politikë të Serbisë, të përkrahur nga ndërkombëtarët dhe kriminelët vendorë, po këmbëngulin që të ndërrohen ligjet e Kosovës sikur edhe Kushtetuta, për t'i dhënë një status special kësaj "OJQ-je" në kohën kur nuk e pranojnë transformimin e FSK-së në ushtri, as përmes ligjit e as përmes ndryshimeve kushtetuese! Këtë nuk do ta pranoni as shtetet e shekullit XVIII e lëre më shtetet që synojnë integritet eu(v)ro-atlantike. Natyrisht se Bashkësia e Komunave Serbe në Kosovë nuk do të formohet sipas vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, por vetëm sipas Marrëveshjes së Brukselit. Do të mbështillet me një tym sa për t'i qetësuar gjakrat dhe asgjë më tepër. Bashkësia e Komunave Serbe në Kosovë do të jetë goditja më e madhe që do t'i bëhet Kosovës duke

krijuar një mekanizëm kushtetues që, me ligje do ta ketë të mundur ta bëjë shantazhin dhe do të krijojë destabilizim afatgjatë, deri në ndarje përfundimtare të kësaj pjese të Kosovës. Tash, kryesisht dhe vetëm shkak i shqiptarëve, si shumicë absolute në Kosovë përjashtohet referendumi, si shprehje dhe mundësi demokratike për t'u përcaktuar për të gjitha çështjet me interes për Kosovën dhe qytetarët e saj. Pas një kohe situata do të ndryshojë, serbët e komunave serbe në Kosovë do të kërkojnë referendum për ta shprehur vullnetin e tyre politik dhe kombëtar duke u thirrur në referendum, si instrument demokratik dhe do të ndahen nga Kosova ose, në rastin më të mirë, do të mbesin brenda kufijve të Kosovës, por më të fortë dhe më vendim-marrës se vetë shteti i Kosovës. Serbia nuk e lëshon Ujmanin dhe Trepçën, prandaj po i instrumentalizon serbët e Kosovës, kurse ndërkombëtarët do të gjejnë interes te Trepça dhe as që do t'ua ndiejë për Kosovën. E patë gjeneralin Klark, erdhi në Kosovë dhe i kritikoi udhëheqësit kosovarë, kurse vizita e tij ishte ekskluzivisht për biznes në Rrafshin e Dukagjinit, kërkesë kjo që i ishte refuzuar më parë. Gjenerali Klark do që të thëngjillin e varfër të Kosovës me kalori ta shfrytëzojë për prodhimin e karburanteve paçka se do ta bëjë mjedisin në këtë pjesë të Kosovës sikur Hiroshima, pas shpërthimit të bombës atomike. Tre musketirët e mashtrimit dhe të rrenës e përkrahin Thaçin si kryenegociator pa pasur mandatin e Kuvendit të Kosovës në ndërkohë që e ka ndërruar postin, nga kryeministri është bërë president e që nuk i garanton të drejtën e kryenegociatorit me automatizëm. Nëse Hashim Thaçi e merr mandatin nga Kuvendi i Kosovës të jetë kryenegociatori i bisedimeve atëherë nuk mund të kundërshtohet nga askush mirëpo, edhe në atë rast nuk mund të marrë ndonjë vendim, pa pëlqimin e shumicës së deputetëve të

Kuvendit të Kosovës. Këta tre musketirë po e keqpërdorin situatën kur Hashim Thaçi është bërë lojtar, jo i besueshëm, por i pazëvendësueshëm për Brukselin dhe Uashingtonin, derisa t'i përfundojë disa marrëveshje pas të cilave, nuk kam asnjë dyshim e pret "fati" i të gjithë liderëve të shteteve ballkanike! Hashim Thaçi ka pasur simpati dhe përkrahje për luftën që e ka bërë kundër Serbisë dhe çlirimit të Kosovës e këtë luftë e ka bërë, pa asnjë dyshim. Thaçin e kam përkrahur deri në çastin kur kam qenë i sigurt se është kundër Serbisë dhe për Kosovën mirëpo, pas shumë veprimeve që i ka bërë kohët e fundit, po del se Serbia po fiton, kurse Kosova po humbet! Nuk ka nevojë më Kosova të bëjë lëshime ndaj Serbisë, as të dhimbshme e as të padhimbshme dhe marrëveshja mund dhe duhet të bëhet ekskluzivisht mbi bazën e mosndërrhyrjes në punë të brendshme të Kosovës. Serbia duhet të merret me çështje të shtetit të Serbisë sikur që edhe Kosova me çështje të Kosovës dhe thjesht kjo është formula e normalizimit të marrëdhënieve midis dy shteteve! Serbia nuk është e interesuar për normalizim, kurse Kosova nuk ka guxim të kundërshtojë një shtet me udhëheqje kriminale siç është kjo e Vuçiçit, Daçiçit, Vulinit, Gjuriçit dhe mendësisë rrugaçerore të regjimit serb që me asgjë nuk dallon nga ai i Millosheviçit. Ndërkombëtarëve nuk u duhen lojtarë kosovarë që shënojnë në golin e Serbisë, por ata që shënojnë në golin e Kosovës që e kanë bërë me përlësinë më të madhe deri më sot! Nëse Kosova hynë në bisedime përfundimtare me këta lojtarë që i trukojnë rezultatet sikur kanë bërë deri më tani, Kosova është e humbur që tani. Bashkësia e Komunave Serbe në Kosovë, nëse miratohet sipas kërkesës së serbëve dhe Serbisë, përfundimisht do ta varrosë pavarësinë e Kosovës, e tillë siç është dhe do ta shndërrojë Kosovë në një mbetje mortore të një shteti! Politikisht dhe

strategjikisht, Kosova do t'i ngajë Spartës e cila u shkatërrua pas një qëndrese titanike, kurse Kosova do të "zhdukët" pas një dorëzimi dhe nënshtrimit titanik! Në këto rrethana, Hashim Thaçi nuk mund të jetë përfaqësues imi dhe përcaktues i fatit tim vetëm se këtë e duan tre musketirët e rrenës, mashtrimin dhe nënshtrimin!

Lutjet e mëngjesit për lakuriqët e natës: Si popull i lashtë dhe me tradita kemi filluar shpronësimin nga vlerat që na kanë karakterizuar për shekuj me radhë. Lakërorin e dikurshëm tash po e quajmë picë, Karagjorgjeva shniclla po e quajmë Skenderbeg, emrat e bukur shqiptarë i kemi zëvendësuar me emra fetarë dhe emra të serialeve televizive që nuk kanë asnjë kuptim dhe asnjë vlerë. Në bastardimin e vlerave dhe përmbajtjes kombëtare dhe morale kemi shuar shumë larg, tash nuk është entuziazmi dhe krenaria e të qenit shqiptar, por e kemi krijuar një krenari fals, të deklarohemi si kosovarë. Po e shohim që me sa rivalitet po pritët loja "miqësore" midis kombëtareve të Shqipërisë dhe Kosovës e që kështu nuk ka ngjarë edhe kur janë takuar Shqipëria me Serbinë. Në kontekstin e imitimeve dhe largimit nga origjinaliteti njerëzor dhe kombëtar, klička jonë po i organizon të ashtuquajturat "lutjet e mëngjesit". Nga lakuriqët e natës, në Shqipëri dhe në Kosovë. Në këto lutje nuk mbeti kush pa shkuar nga Kosova, me robë, tesh dhe kotesh dhe me mëditje të shtetit të Kosovës. Dhe duke u lutur që të mos ndryshojnë mëditjet dhe se këso manifestime të mbahen edhe më shpesh. Pastaj vazhduan për Venedik, sigurisht për ta hulumtuar të kaluarën dhe raportet e Skenderbe Kastriotit me Republikën e Venedikut. Patriotë të paparë janë. Mbase kanë lundruar me gondola nëpër Canale Grande dhe kanë kaluar nën Urën e Psherëtimit apo të Lotëve - Il ponte dei sospiri që aq bukur e përshkruan Manxoni i madh. Psherëtimat vinin nga të burgosurit e syrgjynosur e që për dallim, Dubrava dhe Burgu për Siguri të Lartë në Gërdoc janë hotele me pesë yje. Sa për informatë. Po më bënë përshtypje ministri i Kulturës, z. Kujtim Gashi, që nuk po lë

ngjarje apo festival me përmbajtje kulturore që nuk merr pjesë. I shoqëruar me një duzinë "kulturologësh" që me kulturë kanë lidhje aq sa kam unë me hundëzakët e Adem Salihajt. Mbase mëditjet janë kriter i vetëm kulturor me të cilët janë pajisur këta "haxhilerë" të kulturës! Mund edhe të gaboj shkaku se për shumë gjëra kam mbetur mbrapa dhe pa informata. Në këto lutje të mëngjesit ishte një urim, më së paku që mund ta them me përmbajtje idiotike dhe nënshtruese si ajo e Ilir Skraparit i cili nuk lutej që Shqipëria të normalizohet, të bëhet një shtet i respektuar dhe i mirëqenë për të gjithë qytetarët e saj, por se lutet (sikur Hashimi) që bisedimet midis Serbisë dhe Kosovës të jenë të suksesshme ani pse e dinë se deri më tani humbës absolut i këtyre bisedimeve është Kosova falë hashimave dhe ilirave, të Kosovës dhe të Shqipërisë!

A mbeti kush pa u bënë mistrec në Kosovë: Diku, në një medium të shkruar, lexova se Adem Demaçi dhe Rexhep Qosja paskan qenë mistrecë sepse nuk e kanë vlerësuar figurën "historike" të "presidentit historik" dhe se, madje, e paskan luftuar atë. Secili që merr vesh dy gramë në politikë e ka të qartë se sa për Ibrahim Rugovën kurrë nuk do të bëhej luftë në Kosovë dhe se është qesharake të bësh përpjekje ta marrësh luftën dhe ushtrinë pa e merituar atë. Është shumë e qartë se luftën e ka bërë UÇK-ja dhe se nuk ka pasur ushtri tjetër dhe se për mua nuk është me rëndësi përkatesia politike e ushtarëve të UÇK-së, por gatishmëria dhe vullneti për të luftuar për lirinë e Kosovës dhe bashkimin kombëtar. Për mua është vlerë e papërsëritshme kombëtare Agim Ramadani, Sali Çeku dhe shumë të tjerë që luftuan dhe dhanë jetën për këtë që e gëzojmë dhe po e shpërdorim sot. Ata e bënë detyrën e tyre dhe e dhanë jetën që e kemi pasur detyrim të gjithë dhe është e pandershme manipulimi apo përfitimi politik dhe material duke u mbështjell me lëkurën e tyre e që i bie sikur që bëni përpjekje që trupin e luanit ta mbështillni me lëkurë të qenit. Kjo nuk bëhet kurrë. Populli shqiptar i ka pasur dy vlera sublimë sakrifikuese, Bacën e Madh Adem Demaçin që bëri afërsisht 30

vjet burgim për lirinë edhe të atyre që nuk a kanë merituar sikur edhe të pavdekshmin, komandantin legjendar Adem Jashari. Që të dy e bënë sakrificën në kohën e duhur dhe në vendin e duhur dhe, jam i sigurt se askush në historinë e mëparshme nuk do t'ua kalojë. Momenti dhe koha i bëri të tillë dhe këto momente dhe kohë nuk mund të përsëriten më! Del dikush e thotë se Adem Demaçi dhe Rexhep Qosja janë mistrecë ani pse e ka të qartë se edhe baca Adem sikur edhe bardi i kulturës shqiptare, Rexhep Qosja, edhe në kohën kur janë bërë synet kanë qenë më të mençur se ky farë drandafil i që nuk ka fije respekt për 30 vjet burgim të Adem Demaçit sikur edhe ka kompleks të pashëruar të inferioritetit në planin intelektual përballë Rexhep Qosjes. Mbase i ka pëlqyer më shumë koha kur Baca Adem ka qenë në burg sepse ky farë drandafil është ndër i lirë në llumin e "bratstvo - jedinstvo" (vëllazërim - bashkimit) jugosllav dhe serb dhe se gjuhën serbe dhe kulturën jugosllave e ka pasur më të afërt se atë shqiptare. Askush nuk ia ndalon askujt ta dojë Rugovën, ta fetishizojë atë, por nuk ka të drejtë të na imponojë si vlerë që duhet ta përkrahim të gjithë dhe pa përjashtime. Në këtë kontekst nuk i kuptoj ata që e shajnë presidentin post-historik sepse e paska dekoruar presidentin historik. Thaçi e do fort Rugovën dhe këtë e kanë të qartë të gjithë, përveç Driton Selmanajt dhe familjes Rugova. Thaçi e ka gjuajtur karremin me një znaçkë në të cilën, për shumë arsye (mundohem t'i kuptoj drejt) ka rënë familja Rugova. Pse të sulmohet Thaçi që e ka luajtur lojën që e luan me të gjithë e të mos sulmohet familja Rugova që është bërë pjesë e kësaj loje, në çdo aspekt të ndyrë. Driton Selmanaj po tregohet oportunist, në mungesë të guximit t'i bie kalit, i mëshon samarit! Në këtë mënyrë katërçipërisht e vërteton faktin se gjithmonë kur ish-pjesëtarët e shoqërisë civile shfaqin ambicie për politika të mëdha, zakonisht punën e bëjnë m..t! Nëse nuk keni të kaluar, e sotnjë, kryesisht e improvizuar, nuk ua përmirëson dhe pastron të kaluarën dhe, në fund, kurrë nuk ju siguron biletë për të ardhmen siç e dëshironi, por që me asgjë nuk e meritoni!



Digjet vetura e pjesëtarit serb të FSK-së

ZUBIN POTOK, 28 MAJ (ER) - Vetura e markës "Opel Corsa", në pronësi të J. J., pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës, është djegur rreth orës 2:00 të mëngjesit, në fshatin Zupq të Komunës së Zubin Potokut.

Në një komunikatë për media të Policisë së Kosovës thuhet se nuk është raportuar për ndonjë të lënduar derisa rasti është duke u hetuar.

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) ka reaguar kundër djegies së veturës të pjesëtarit serb të FSK-së. MFSK-ja ka vlerësuar se sulmet e tilla janë akte kriminale dhe të dënueshme. "Këto akte kriminale bëhen me qëllim që t'i frikësojnë pjesëtarët e FSK-së

nga qarqet kriminale dhe nacionaliste serbe në pjesën veriore, të cilat shprehin urrejtje dhe papajtueshmëri me integritet, zhvillimin e demokracisë dhe konsolidimin e shtetit të Kosovës", është thënë në reagimin e MFSK-së.

Në fund të muajit shkurt të këtij viti ka pasur kërcënime kundër disa pjesëtarëve serbë të FSK-së. Ata janë kërcënuar me anë të disa pamfleteve të shpërndara në Zubin Potok. Kërcënimet kanë pasuar parakalimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës nëpër sheshet e Prishtinës me rastin e 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, ku ishin të pranishëm edhe pjesëtarët serbë të FSK-së.

Deputeti gjerman: Të hapen negociatat me Shqipërinë

TI RANË, 28 MAJ - Mark Hauptmann, deputeti i CDU-së në Bundestagun gjerman, tha gjatë takimit me kreun e grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, se do t'u sugjerojë kolegëve të vet në Gjermani të hapen negociatat me Shqipërinë. "Siç e dini brenda BE-së ka debate për zgjerimin ose jo të mëtejshëm të Unionit. Jam i mendimit se duhet të hapen negociatat me Shqipërinë, sepse për ne nuk konsiderohet si përfundimi i reformave, por fillimi i reformave. Do t'ua sugjeroj kolegëve

të mi mbështetjen ndaj Shqipërisë për hapjen e negociatave", tha Hauptmann. Duke vlerësuar progresin e Shqipërisë, ai tha se Shqipëria është një partner që duhet mbështetur. "Është e qartë se Qeveria ka një agjendë reformash, reforma në drejtësi dhe një sërë reformash të tjera në luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe parandalimin e emigracionit të paligjshëm. Në këtë aspekt Shqipëria është partner për ne dhe duam ta mbështesim në rrugën e mëtejshme", tha deputeti Hauptmann.



Apeli i heq masën "arrest shtëpie" për Tahirin

Tiranë, 28 maj - Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda ka vendosur ta heqë masën "arrest shtëpie" për ish-ministrin Saimir Tahiri. "Apeli shfuqizoi masën arrest shtëpie për ish-ministrin", u shpreh avokati i Tahirit, Maks Haxhia. Më herët, avokati i

Saimir Tahirit, Maks Haxhia e ka interpretuar në dy pjesë mesazhin e një dite më parë dhënë nga ambasadori amerikan Donald Lu. Sipas tij, provat janë më të forta, dhe nëse gjykata gjykon në bazë të tyre, sot duhet të hiqet masa e

arrestit për klientin e tij. "Atë mesazh e ndava në dy pjesë, mesazhin e qarkullimit të opinionëve siç ndodh rëndom në Shqipëri kur ka gjithmonë çështje të tilla pikante, ose me probleme sociale politike, që të dyja palët kundërshtare, ose dhe

metoda të tilla që nuk duan të jepet vendimi kundër, hapin fjalë që qarkullojnë presione ose para. Ajo që jam i interesuar si specialist i së drejtës dhe në detyrën e avokatit të Tahiri është mesazhi i Lusë, që ishte shumë i rëndësishëm është që Gjykata



duhet të gjykojë në prova dhe në ligj", tha Maks Haxhia.

NATO-ja shpalos agjendën për samitin e korrikut

BRUKSEL, 28 MAJ - NATO-ja tha të hënën se do të përqendrohet në pesë fusha kyçe, nga modernizimi deri te marrëdhëniet me Bashkimin Evropian, në samitin që do të mbahet në korrik. NATO-ja vuri theksin edhe mbi menaxhimin e marrëdhënieve me, siç

tha, një Rusi gjithnjë e më kategorike.

Sekretari i përgjithshëm i aleancës ushtarake, Jens Stoltenberg, tha para Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Varshavë, se samiti do të përqendrohet edhe në "projektimin e stabilitetit në rajonet

kufitare, sidomos në jug, si dhe në ndarjen e shpenzimeve".

Duke u bazuar në vendimin e Aleancës për vendosjen e grupeve luftarake në krahun e saj lindor, që kufizohet me Rusinë, Stoltenbergu tha se pret që në samitin e 11 dhe 12 korrikut në

Bruksel, udhëheqësit e shteteve të marrin vendime edhe mbi përforcimin e gatishmërisë ushtarake. "Mbrojtja jonë nuk varet vetëm nga forcat që i kemi vendosur, por edhe nga aftësia jonë për t'i lëvizur ato forca shpejt nëse është e nevojshme", tha Stoltenbergu.



Maqedonia dhe Greqia arrijnë marrëveshje kornizë rreth emrit

Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë, Nikolla Dimitrov, pas takimit në Bruksel me shefin e diplomacisë greke, Nikos Kotzias, ka njoftuar për arritjen e një marrëveshje kornizë për Greqinë për çështjen e emrit

SHKUP, 28 MAJ - Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë, Nikolla Dimitrov, ka njoftuar për arritjen e një marrëveshje kornizë me Greqinë për çështjen e emrit. Ai i ka bërë këto deklarata për agjencinë MIA, pas takimit në Bruksel me shefin e diplomacisë greke, Nikos Kotzias. "Kishim takim produktiv. Kemi kornizë që duhet të përpunohet dhe momentalisht grupet e juristëve të të dy ministrive po punojnë për përmbajtjen e saj. Planifikohet një takim i rëndësishëm në nivel të kryeministrave, Zaev dhe Cipras, nga mesi

i javës. Besojmë se do të përcaktojnë disa punë të rëndësishme nga opsionet që janë në lojë", deklaroi Dimitrov pa dhënë detaje mbi përmbajtjen e kornizës.

Dimitrov të hënën kishte një takim joformal me ministrat e punëve të jashtme të BE-së apo zëvendësit e tyre. Siç bëhet me dije, Franca dhe Holanda kanë mbajtur qëndrimin e fortë për mosdhënien e datës për nisjen e bisedimeve, ashtu dhe siç pritej. Por, Dimitrov ka thënë se "janë të mundshme çudira". "Është e mirë të dimë se kjo nuk është punë e thjeshtë. Konsolidimi i



brendshëm i BE-së është komplementar dhe jo në kundërshtim të konsolidimit të Ballkani.

Nuk jemi në situatë që të kemi

luks dhe ta lëshojmë shansin historik", ka deklaruar Dimitrov. Zyrtarët e lartë të Bashkimit Evropian kanë njoftuar për progres në bisedimet për zgjidhjen e kontestit. "Të gjithë jemi shumë të inkurajuar nga përparimi mes Shkupit dhe Athinës për emrin. Të gjithë do të punojmë të mbështesim një epilog pozitiv", ka deklaruar shefja e politikës së jashtme e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini. Edhe komisionari i Zgjerimit, Johan Hahn, ka mirëpritur kthesën pozitive në procesin e bisedimeve duke theksuar se kjo do ta ndihmonte procesin e integritetit euroatlantik të Maqedonisë. Bisedimet në Bruksel pasojnë ato në Nju Jork ku dy palët nuk arritën progres pasi Greqia hodhi poshtë propozimin, "Maqedonia e Ilindenit".

Migranti që shpëtoi katërvjeçarin fiton shtetësinë franceze

PARIS, 28 MAJ - Një migrant nga Mali, i cilësuar hero, pasi shpëtoi një djalë të vogël, i cili varej në një ballkon në Paris, do të shpallet shtetas francez.

Mamoudou Gassama u ngjitur jashtë ndërtesës për ta shpëtuar katërvjeçarin.

Një video e cila është transmetuar nga televizionet franceze shihet Gassama duke u ngjitur nga ballkoni në ballkon deri në katin e katërt për ta shpëtuar fëmijën.

Për këtë heroizëm të treguar, Mamoudou Gassaman e ka pritë në Pallatin Elysee, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, i cili ka thënë se

Gassama do të bëhet shtetas i natyralizuar.

Macron e ka dekoruar Gassaman me Medaljen e Guximit dhe i ka ofruar punë në shërbimin e zjarrfikësve. Gassama ka thënë se ka arritur në Francë vitin e kaluar, duke bërë udhëtimin e gjatë dhe të rrezikshëm për në Evropë përmes Detit Mesdhe.

Gassama ka deklaruar se ka qenë duke kaluar andejpari kur ka parë një turmë të mbledhur para një ndërtese në Paris. "Nuk kam pasur kohë të mendoj, kam kaluar turmën dhe kam shpëtuar fëmijën", është shprehur ai.



Parlamenti spanjoll diskuton mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë

MADRID, 28 MAJ - Parlamenti spanjoll pritet të debatohet mbi një mocion mosbesimi kundër Qeverisë së kryeministrit Mariano Rajoy të enjten dhe të premten.

Lajmi u njoftua me një postim në "Twitter" nga kryetari i parlamentit.

Votimi mbi mocionin, i thirrur nga partia kryesore e opozitës ajo socialiste, duhet të zhvillohet në fund të debatit ditën e premte. Por votimi mund të shtyhet edhe për të shtunën, sipas një zyrtari të parlamentit.

Socialistët e parashtruan

mocionin që kërkon rrëzimin e kryeministrit Rajoy në parlament ditën e premte, një ditë pasi një gjykatë gjobiti partinë e tij, atë Popullore, për përfitim nga fonde të paligjshme gjatë një procesi të gjerë gjyqësor lidhur me marrje rryshfetes.

Gjykata Kombëtare e Spanjës tha të enjten se kishte zbuluar një sistem të gjerë të marrjes së rryshfeteve që u ishin dhënë ish-zyrtarëve të Partisë Popullore në këmbim të kontratave publike fitimprurëse mes viteve 1999-2005.



Këndvështrim

'Bardhësitë e atdheut', libër kapital për të gjithë shqiptarët

Bilall MALIQI,
shkrimtar

Libri "Bardhësitë e atdheut", i autorit Afrim Mustafa, është një enciklopedi e rrallë për të gjithë heronjtë e tri luftërave çlirimtare, me 3 000 dëshmorë të të gjitha krahinave të ndara padrejtësisht nga trangu i vetëm shqiptar, Shqipëria.


Ky libër kapital për autorin, por edhe për shqiptarët në përgjithësi, jep një pasqyrë reale, si dhe letërnjoftimin e të

gjithë këtyre dëshmorëve të kombit, të cilët dhanë jetët e tyre për çlirim të tokave shqiptare.

Autori i librit ka bërë punë kolosale në përmbledhjen e të gjithë aktorëve të lirisë që t'i fusë brenda kopertinave të këtij libri me përmasa gjithëkombëtare, e cila do të mbetet pasuria më e madhe e shqiptarëve, sepse do t'i kenë të gjithë këto lule të lirisë në një libër, siç kanë qenë të betuar para flamurit për t'i çliruar të gjitha trojet e shkëputura shqiptare, për t'ia

bashkuar nënës Shqipëri.

Gjithashtu, lexuesi këta heronj të kombit, të cilët ndryshuan historinë gjithëkombëtare për 90 shkallë, do t'i ketë parasysh në çdo kohë, sepse po këta ia fituan lirinë, që të gjithë ne të frymojmë, punojmë e të shkruajmë lirshëm, pa kurrfarë droje. Këta heronj të prezantuar brenda kopertinave të librit voluminoz japin gjithë atë mesazh për të gjithë ata armiq të jashtëm dhe të brendshëm, se me atdheun nuk luhet dhe se është i shtrenjtë sa vetë jeta.



Kujtojmë se kjo vepër e gjallë me personazhe të gjalla, të cilët kanë vetëm datën e lindjes, është monument në vete, sepse në të janë 3 000 shtatore me 3 000 kurora lulesh, të cilat i japin hijeshi atdheut.

Këtë libër duhet ta ketë çdo familje shqiptare, çdo komunë, çdo bibliotekë, secila zyrë, sepse aty gjenden yjet e lirisë, tok me yllin e gjallë (autorin) që i tuboi të gjithë këta atdhetarë, pasardhës të trimave, e që me ta lavdërohem ne, lavdërohet edhe historia jonë.

Nënshkruhet marrëveshja për restaurimin e Qendrës Historike të Prizrenit

PRIZREN, 28 MAJ (ER) - Në kryeqytetin historik të Prizrenit, vendim që tashmë e ka marrë Qeveria e Kosovës, të hënën u nënshkrua letra e marrëveshjes për hartimin e planit për revitalizimin dhe integrimin socio-ekonomik të komunitetit lokal në rrugën "Marin Barleti" në Prizren.

Marrëveshja u nënshkrua ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Zyrës së BE-së në Kosovë, përfaqësuesit special të BE-së, Komunës së Prizrenit, Ambasadës Britanike në Prishtinë dhe OJQ "Ec Ma Ndyshe". Kjo marrëveshje parasheh realizimin e projektit në përputhje dhe duke përbushur objektivat e Strategjisë Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës (2017-2027) dhe ka për qëllim hartimin e një dokumenti strategjik për menaxhim dhe mirëmbajtje të trashëgimisë kulturore dhe rikthim të qëndrueshëm dhe integrim të komunitetit lokal nëpërmjet zhvillimit ekonomik; përgatitjen e projekteve prelim-

inare për restaurimin e 14 ndërtesave të trashëgimisë kulturore në rrugën "Marin Barleti"; përgatitjen e projektit preliminar të dizajnit urban për rrugën "Marin Barleti" që përfshin aspektet teknike dhe mobilinë urbane.

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, i cili e nënshkroi këtë marrëveshje në emër të MKRS-së, vlerësoi se nënshkrimi i marrëveshjes shumëpalëshe bëhet konform zbatimit të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligjit për Trashëgimi Kulturore dhe në përputhje me obligimet dhe detyrat zyrtare. "Me rastin e nënshkrimit të letres së marrëveshjes po tregojmë qartë vullnetin dhe gatishmërinë tonë për të ndërmarrë disa veprime konkrete për Qendrën Historike të Prizrenit", ka thënë ministri Gashi, duke shtuar se në zbatim të Ligjit për Trashëgimi Kulturore, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ai si ministër në vazhdimësi kanë qenë të angazhuar për procesin e



inventarizimit dhe dhënies së statusit të mbrojtjes së përkohshme për asetet e trashëgimisë kulturore, ndërmarrjes së masave preventive-intervenive emergjente. Ministri Gashi ka njoftuar për veprimet që ka ndërmarrë MKRS-ja për trajtimin, konservimin dhe restaurimin e

objekteve të trashëgimisë si dhe për rritjen e buxhetit në këtë sferë. "Në vitin që lamë pas janë trajtuar 21 ndërtesa nga ana e QRTK-së në Prizren si institucion në vartësi të MKRS-së, kurse gjatë këtij viti kanë filluar të zbatuari edhe dhjetëra projekte konservuese-restauruese në QHP; QRTK e Prizrenit ka në

dispozicion rreth një milion euro për ndërhyrje restauruese konservuese si dhe intervenime emergjente për QHP-në", është shprehur ministri Gashi, duke theksuar faktin se me të marrë detyrën si ministër e ka shumëfishuar buxhetin për QHP-në në përputhje me kërkesat dhe nevojat kjo qendër.

Ministri Gashi ka thënë se MKRS-ja ka mbështetur financiarisht shoqërinë civile për përgatitjen e Planit të Menaxhimit për QHP-në. "Unë si ministër i MKRS-së e vlerësoj lart gatishmërinë e palëve të përfshira në këtë proces, në këtë rast Zyrës së BE-së, Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar si dhe Komunës së Prizrenit për nënshkrimin e kësaj letër marrëveshje, por dua ta potencoj faktin se duhet të shpejti ta nënshkruajmë memorandumin e bashkëpunimit ku do të definoreshin qartë të gjitha detyrat dhe përgjegjësit e secilit institucion veç e veç duke marrë për sipër obligimet dhe barrën që na takon", ka thënë ministri Gashi.

Akademia e Shkencave dhe UP-ja nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

PRISHTINË, 28 MAJ (ER) - Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK) dhe Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" kanë nënshkruar të hënën një memorandum mirëkuptimi, i cili është nënshkruar nga udhëheqësit e të dy institucioneve të larta shkencore dhe arsimore, kryetari i AShAK-ut, Nexhat Daci dhe rektori i UP-së, Marjan Dema.

Memorandumi në fjalë ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe të bashkëveprimit për ngritjen dhe promovimin e perfor-

mancës në të gjitha fushat e interesit të përbashkët si dhe t'i përcaktojë fushat fundamentale të kërkimeve akademike në të cilat palët janë të interesuara të punojnë së bashku në të ardhmen.


Udhëheqësit e të dy institucioneve janë zotuar të punojnë për zbatimin e pikave të këtij memorandumit të mirëkuptimit, i cili është dokumenti i parë i këtij lloji i nënshkruar nga përfaqësuesit e këtyre dy institucioneve të larta akademike.



E jashtëzakonshme

Nëna e kafshuar nga gjarpri i jep gjë vogëlushes, vdesin të dyja

Një grua në Indi vdiq pasi u kafshua nga një gjarpër, ndërsa humbi jetën edhe vajza e saj, pasi qumështi i nënës ishte helmuar. Sipas medieve lokale, gruaja 35-vjeçare në provincën Uttar Pradesh është kafshuar në gjumë nga një gjarpër helmues. Në Indi ka rreth 300 lloje të gjarpërinjve



dhe çdo vit 46 mijë persona humbin jetën si pasojë e kafshimit nga gjarpërinjte.

BARSOLETA E DITËS



I thotë shoku shokut:

- Na thuaj ndonjë gjë të re?
- Më ka tradhtuar gruaja, - i thotë ai.
- Unë të pyeta për ndonjë gjë të re.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 15:00

“AVENGERS: Infinity War” 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



FOTO E DITES



Kuajt e egër në një shfaqje në Duermen të Gjermanisë. /AP/

Në ora 18:00

“ISLE OF DOGS”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

“DEADPOOL 2” (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

Regjia: David Leitch

Gjatë vikendit 19 dhe 20 maj, “DEADPOOL 2” do të shfaqet në ora 13:00 dhe 20:00.



E rrallë

Shkencëtarët në Francë masin 'lumturinë' e delfinëve

Shkencëtarët, të cilët punojnë me delfinët në parkun ujqor afër Parisit, janë përpjekur t'i masin ndjenjat e delfinëve që jetojnë në rezervate. Kërkuesit thonë se ky është projekti i parë për ta ekzaminuar gjendjen e delfinëve gjatë kohës që janë 'në robëri' dhe cilat aktivitete ata pëlqejnë më shumë. Ata zbuluan se gjitarët ujorë parapëlqejnë të bashkëveprojnë me një njeri të njohur për ta.




Në ora 22:00

“I FEEL PRETTY”

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).




DASHI

Nëse sot nuk e keni ditën shumë të ngarkuar mund të merrni kohë boll për t'iu përkushtuar pasioneve tuaja.



DEMI

Keni marrë përsipër më shumë gjëra nga sa mund të përballoni. Do t'ju nevojitet t'i ndani mirë objektivat tuaja parësore.



BINJAKËT

Dikush ju ka besuar një sekret sot dhe me këtë gjë ka provuar që ju konsideron vërtet mik. Do të bëni të pamundurën për ta ndihmuar.



GAFORRJA

Nuk mund t'i përgjithësoni gjërat sot. Çdo situatë duhet vlerësuar për atë që i takon, jo duke u bashkuar me situata të tjera të ngjashme.



LUANI

Mundohuni të realizoni në praktikë çdo ide që keni menduar kohët e fundit. Kështu që do të kuptoni nëse ia vlen vërtet mundimi.



VIJGJËRËSHA

Keni kërkuar kohë për të bërë disa zgjidhje për ju dhe për partnerin. Në momentin e duhur, është mirë t'i komunikoni zgjidhjet tuaja.



PESHORJA

Edhe pse jeni përqendruar në disa projekte paralelisht, do të arrini t'i realizoni. Nuk ka asgjë të keqe të kërkonte më të mirën nga vetja.



AKREPI

Keni pasur shumë energji negative kohët e fundit dhe i keni shprehur me njerëzit që ju kanë qëndruar pranë.



SHIGJETARI

Edhe pse i jeni përkushtuar shumë një personi të caktuar, nuk keni marrë asgjë në shkëmbim. Bëni mirë të ripozicionoheni.



BRICJAPI

Është mirë t'i shembni muret që janë krijuar mes jush dhe një pjesëtari tjetër të familjes. Toleranca është një zgjidhje mjaft e mirë.



UJORI

Sot mundohuni të jeni më produktiv dhe mos krijoni polemika të kota. Idetë që keni kërkojnë suport financiar.



PESHQIT

Ndonjëherë pa e vënë re merrni një sjellje distante, gati snob. Është mirë ta moderoni mënyrën e sjelljes.

Alicia Silverstone po divorcohet nga burri




Alicia Silverstone ka paraqitur dokumentet për divorc. Aktorja dhe muzikanti 41-vjeçar, Christopher Jarecki, njoftuan për ndarjen e tyre në shkurt, por deri

tani nuk janë divorcuar zyrtarisht. Sipas "TMZ"-së, ata cituan dallime të papajtueshme si arsye për ndarjen dhe do të vendosin se si do të planifikojnë t'i ndajnë pasuritë e tyre.

Kylie Jenneri i blen dhuratë 2 000 dollarë fansit



Kylie Jenner i ka blerë një dhuratë të shtrenjtë për ditëlindje një prej fansave më të mëdhenj. Ylli i The Life of Kylie surprizoi fansin Johnny Cyrus i cili mbushi 21 vjet. Johnny pothuajse është gjithmonë i pari në ngjarjet e Kyliet, që ka sjellë një miqësi të bukur midis të dyve. Ky fans mori dhuratë një çantë "Louis Vuitton" në vlerë 2 010 dollarë.



Pritje madhështore për Rita Orën në Hamburg

Rita Ora ka vazhduar me turneun e saj ku destinacionet e shumta janë në Evropë. Pasi filloi koncertet në Gjermani në Dusseldorf, superylli shqiptar ka vazhduar të mbajë koncert të madh në Hamburg. As ngjarjet e mëdha si

finalja e Ligës së Kampionëve nuk ka ndaluar dhjetëra mijëra adhurues të Ritës që të dalin në performancën e saj. Rita Ora pritet ta vazhdojë turneun evropian, ku shumë shpejt performon edhe në Shqipëri me ftesë të kryebashkiakut, Erion Veliaj.

Shtatzënë dhe duke tymosur



Chloe Green po i vazhdon pushimet në Monako me të dashurin Jeremy Meeks dhe familjen e saj. Dhe Chloe Green është fotografuar derisa po tymoste

cigare elektronike në super-jahtin luksoz të babait të saj miliarderit Philip Green. Chloe është shtatzënë me ish të burgosurin Jeremy Meeks.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

MEXICO - WALES

1

DINAMO BREST - DNEPR MOGILEV

1

HELSINKI - SJK

1

Haliti: Për trofe u riktheva te Prishtina

Ahmet Haliti e ka lënë Feronikelin për t'iu bashkuar Prishtinës. Ai ka arritur marrëveshje njëvjeçare me skuadrën kryeqytetase, kurse me këtë skuadër ka synime shumë të mëdha. "Jam i lumtur që jam rikthyer sërish te Prishtina, e cila është një skuadër që gjithmonë lufton për trofe. Premtoj maksimumin dhe dua të fitoj sa më shumë trofe që është e mundur. Për t'i thënë po Prishtinës, duke e parë organizimin e klubit, kushtet, ambientin që e njoh, por edhe për mundësinë që të luajë në Evropë, nuk ishte vështirë", ka thënë Haliti

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 MAJ - FC Prishtina vetëm një ditë pasi e fitoi Kupën e Kosovës në futboll ka arritur të realizojë një transferim të madh. Fjala është për mbrojtësin Ahmet Haliti, i cili edicionin e fundit ishte pjesë e Feronikelit. Lajmin për rikthim te Prishtina e ka konfirmuar të hënën për "Epokën e re" vetë mbrojtësi që në të kaluarën e ka djersitur edhe fanellën e Hysit. Haliti është shprehur i kënaqur me këtë lëvizje të bërë, duke premtuar maksimumin në

fanellën "bardhekaltër". "Jam i lumtur që jam rikthyer sërish te Prishtina, e cila është një skuadër që gjithmonë lufton për trofe. Premtoj maksimumin dhe dua të fitoj sa më shumë trofe që është e mundur. Për t'i thënë po Prishtinës, duke e parë organizimin e klubit, kushtet, ambientin që e njoh, por edhe për mundësinë që të luajë në Evropë, nuk ishte vështirë", ka thënë Haliti. Mbrojtësi që pa ndonjë problem të madh e luan edhe pozitën e mesfushorit shkatërrues, ka folur edhe për konkurrencën në skuadrën kryeqytetase. Në këtë klub janë

edhe mbrojtësit me përvojë të madhe Armend Dallku dhe Debatik Curri, por kjo duket se nuk e shqetëson aq shumë Halitin. "Mendoj se në një ekip ku luftohet për titullin e kampionit, por edhe për Kupë, konkurrenca duhet të jetë e tillë dhe ajo vetëm sa të ngrehë si futbollist", ka shtuar ai. Në fund Haliti pati edhe një falënderim për skuadrën e Feronikeit, ku luajti për dy vjet radhazi. "Falënderoj shumë kryesinë e vjetër të Feronikelit, e cila ishte më meritörja që u bëra pjesë e 'Niklit', ndërsa kryesisë së re, në veçanti kryetarit, i



dëshiroj shumë suksese në vazhdim dhe e falënderoj për korrektësinë. Falënderoj shumë tifozët e skuadrës dhe gjithë qytetarët e Drenasit për përkrahjen e dhënë", ka deklaruar ai.

Duhet cekur se Prishtina edicionin 2017/2018 e mbylli në vendin e dytë në kampionat, kurse në Kupë triumfoi falë fitores ndaj Vëllaznimit në penallti.

Sonte vëllazërorja Kosovë - Shqipëri

PRISHTINË, 28 MAJ - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do ta luajë sonte (e martë) ndeshjen miqësore që vlerësohet si përballja vëllazërore me Shqipërinë. Kjo ndeshje zhvillohet në qytetin e Cyrihit në Zvicër dhe fillon në orën 20:00. Pavarësisht se ky është vetëm një takim miqësor, trajneri i Kosovës, Bernard Challendes, kërkon ta mposhtë ekipin kuqezi që drejtohet nga Christian Panucci. "Detyra ime është të punoj dhe ta përgatis ekipin për ndeshjen kundër Shqipërisë dhe për të qenë gati në muajin shtator. Do t'ua jap mundësinë të gjithë futbollistëve ndaj Shqipërisë. Ata kanë një skuadër shumë të fortë, por për mua e rëndësishme është të përgatitemi kundër Azerbajxhanit në muajin shtator. Gjithsesi kam dëshirë ta



fitoj edhe këtë ndeshje", ka deklaruar Challendes. Për ndeshjen miqësore ka folur edhe sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Sokol Cikalleshi. Ai ka thënë se ndeshja ndaj Kosovës është shumë e rëndësishme dhe kërkohet një rezultat pozitiv. "Janë dy ndeshje të

rëndësishme. Më interesantja është përballja me Kosovën, që është si një vëllazërore. Por, ne do të hyjmë në fushën e lojës për ta dhënë maksimumin. Shpresojmë të marrim një rezultat pozitiv si me Kosovën, po ashtu edhe me Ukrainën", deklaroi Cikalleshi.

Messi: Argjentina nuk është favorite në Kupën e Botës

BONUES AIRES, 28 MAJ

- Lionel Messi ka insistuar se Argjentina duhet të shkojë në Kupën e Botës me qetësi dhe përlësi dhe të mos përçojë mesazhe se do të shpallet kampionë sepse, siç thotë ai, ekipi i tij nuk është më i miri në botë. "Duhet të shkojmë në Kupën e Botës me qetësi. Nuk mund të dërgojmë mesazhe se do të bëhemi kampionë sepse sot ne nuk jemi më të mirët. Duhet të jemi realistë, ta kërkojmë ëndrrën me përlësi. Në skuadër kemi loj-



tarë me përvojë dhe cilësi, prandaj edhe mund të eksitohe mi, ama është me rëndësi të fillojmë të fitojmë. Kandidatët kryesorë janë Brazili, Spanja dhe Gjermania", ka thënë Messi.

Dragusha demanton Sejdiun: Vetëm një lojtar refuzoi penalltinë

GJAKOVË, 28 MAJ - Kapiteni i skuadrës së Vëllaznimit, Alban Dragusha, i është kundërpërgjigjur ish-trajnerit, Gani Sejdiut, që deklaroi se futbollistët e ekipit gjakovar hezituan t'i godisnin penalltinë në bal-

lafaqimin në barazh kundër Ferizajt. Dragusha ka mohuar të ketë pasur ndonjë lojtar që ka hezituar t'i gjuajë penalltinë si ka thënë Sejdiu pasi, sipas tij, tekniku mitrovicas ka dashur të hedhë fajin diku tjetër. "Më

vjen keq për të gjithë, sidomos për Gani Sejdiun, pasi që është një prej trajnerëve më të mirë në Kosovë për momentin. Por, për penalltinë i ka caktuar ai me ndihmësit. Vetëm një futbollist ka hequr dorë nga

ekzekutimi i penaltive pasi që nuk është ndjerë mirë dhe ajo është e drejtë e tij, por të thuash se disa futbollistë nuk kanë pranuar t'i gjuajnë penalltinë. ndoshta është munduar ta gjuajë fajin diku

tjetër", ka thënë Dragusha. Kujtojmë se tekniku mitrovicas kishte deklaruar pas ndeshjes së humbur të barazhit se disa futbollistë nuk kanë pranuar t'i gjuajnë penalltinë.

Munishi: Sezon interesant, por me cilësi shumë të ulët

PRISHTINE, 28 MAJ - Drita është kampione e Kosovës, skuadër kjo që do ta përfaqësojë Kosovën në para-kualifikueset e Ligës së Kampionëve. Ndërkaq Prishtina që e fitoi Kupën edhe këtë vit do të luajë në Evropa

Ligë. Ish-futbollisti i njohur, aktualisht trajner tek Kombëtarja e Kosovës tek Femrat, Kushtrim Munishi për "RTKLive", ka thënë se ky sezon ka qenë interesant por, sipas tij, cilësia ishte në nivel të ulët.

"Ishte një sezon shumë interesant për opinionin futboll-dashës sa iu përket rezultateve, por me një cilësi shumë të ulët sa i përket nivelit profesional", ka thënë Munishi. "Sigurisht se është mirë që marrin pjesë në

Kupat Evropiane, por nuk besoj se mund të arrijmë rezultate të mira në garat evropiane, duke u bazuar në kualitetin e treguar gjatë këtij sezoni. Mendoj se niveli i ligës sonë ende është i ulët", ka shtuar Munishi.



Chalandes: 'Lufta' ime është me Shqipërinë, jo me Zvicrën

CYRËH, 28 MAJ - Trajneri i Kosovës, Bernard Chalandes, ka dhënë një intervistë për portalin "albinfo.ch" në prag të takimit miqësor ndaj Shqipërisë që do të luhet të martën. Në këtë intervistë trajneri zviceran ka folur për të ardhmen e përfaqësueses së Kosovës, si e ndjen ai duelin mes vëllezërve, pastaj për luftën e tij, "më pak me Zvicrën dhe më tepër me Shqipërinë", për t'i bindur lojtarët me prejardhje nga Kosova që të luajnë për Kosovën dhe jo për Shqipërinë apo Zvicrën etj.

Si erdhi që ju të jeni në krye të një ekipi të ri si Kosova?

Chalandes: Mund të them se ka qenë pak rastësi. Pas përvojës sime me Armeninë, kisha vendosur të kërkoj një përfaqësuese. Oferta e Kosovës kishte ardhur dhe unë e kisha studiuar, por nuk kisha menduar gjatë dhe thashë: po.

Çfarë ju ka motivuar ta pranoni këtë emërim?

Chalandes: Përfaqësuesja e Kosovës është një skuadër e re të cilën duhet ndërtuar, por është e qartë që e kam studiuar potencialin e ekipit dhe lojtarëve dhe mendoj se lojtarët luajnë në tërë Evropën në klube të mira, por edhe në Kosovë. Në rregull, duhet t'u japim pak kohë, se kampionati është i mirë, por jo mjaftueshëm i mirë për paraqitje ndërkombëtare. Megjithatë, duhet punuar dhe unë besoj në të ardhmen e Kosovës. I kam shikuar lojtarët e të rinjtë dhe kam thënë, në rregull, me këtë ekip ne mund të arrijmë dhe ndërtojmë diçka të mirë.

A është vështirë të ndërtohet një ekip, sidomos duke pasur parasysh faktin se lojtarët vijnë nga jashtë Kosovës dhe se ekipi i Shqipërisë gëzon mbështetje të madhe edhe te kosovarët?

Chalandes: Vështirë nuk është

sepse lojtarët luajnë jashtë vendit. Ne edhe në përfaqësuesen e Zvicrës kemi vetëm një lojtar që luan në kampionatin vendor. Ky nuk është një problem. Kjo është krejt normale, por është e qartë se konkurrenca me Shqipërinë është një problem i vogël për mua. Mirëpo unë e di këtë dhe Panucci i Shqipërisë e di, po ashtu, dhe ne angazhohemi për lojtarë të mirë. Kjo është e qartë. Për mua si trajner i Kosovës është me rëndësi të bëj gjithçka për t'i bindur lojtarët që të luajnë për Kosovën dhe jo për Shqipërinë. Kjo është, po ashtu, një lojë dhe kjo është puna ime, për shembull, për disa lojtarë që janë në Zvicër, për t'i bindur të vijnë tek ne. Mirë, nëse ju nuk mund të luani për Zvicrën, ejani për Kosovën dhe jo për Shqipërinë dhe Panucci vepron njëjtë.

E ndieni presionin e medieve dhe analistëve të futbollit zviceran, se po merrni futbollistë nga Superliga e Zvicrës për të luajtur për Kosovën?

Chalandes: Jo, nuk kam presion. E di shumë mirë dhe gazetarët duhet ta dinë po ashtu, se është një histori e keqe, e gabuar se, për shembull, ja ai e do një lojtar, Chalandes e merr një lojtar nga Zvicra për Kosovën. Kjo nuk funksionon kështu! Lojtarët, familja dhe agjentët vendosin. Ju jap një shembull, nëse një lojtar ka shanse të luajë për Zvicrën, të shkojë me ekipin në KB në Rusi, me këtë gjë unë mund të jetoj, pa problem, dhe nuk dua të luftoj sepse kjo është krejtësisht normale. Lojtari shkon me Zvicrën në Rusi sepse lojtari dëshiron të luaj në nivele të larta edhe për ardhmërinë e vet. Është e sigurt se në fund gjithmonë vendos lojtari dhe jo Chalandes apo Panucci. Ne e kemi parë këtë me Zvicrën: Xhaka luan për Zvicrën, Shaqiri luan për Zvicrën, jo për Kosovën, jo për Shqipërinë, është e qartë. Taluant Xhaka nuk mundi të luajë



për Zvicrën në atë kohë dhe shkoi të luajë për Shqipërinë. Abrashi shkoi tek Shqipëria dhe kjo është normale, është në rregull. Por, tani kemi disa lojtarë të shpresave U21 të Zvicra. Nëse shikojmë Alban Ajetin, ai ka një shans për ekipin e parë të Zvicrës dhe mua më duhet të pres. Lufta ime për mua nuk është me Zvicrën dhe Kosovës. Lufta, ndoshta, është midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Si do t'i përgatitni lojtarët për përballjen e quajtur ndryshe dueli mes vëllezërve? Herën e fundit kundër Shqipërisë keni qenë trajner i Armenisë dhe e keni humbur 0-3, me ç'rast Shqipëria ka siguruar kualifikimin për KE. A është kjo lojë edhe për ju një duel mes vëllezërve apo ju keni një faturë të hapur me Shqipërinë?

Chalandes: Sigurisht, ky është një duel mes vëllezërve. Unë kam qenë pak i befazuar fillimisht si zviceran, kam menduar që është pak më ndryshe, por atje e kam parë se Kosova jeton me Shqipërinë dhe unë nuk e dija a jam në Kosovë, a jam në Shqipëri. Nuk kam parë ndonjë ndryshim. Ekipi nacional i Kosovës ka luajtur kualifikimet në Shqipëri dhe kjo tregon se Kosova dhe Shqipëria jetojnë shumë mirë bashkë. Me humbjen 3-0 nga Shqipëria unë nuk isha më trajner, por loja ime e fundit me Armeninë ishte në Shqipëri. 1-0 për ne dhe në fund ne morëm dy gola me Gashin dhe Lenjanin që krosi. Duhet të

shohim, është një lojë speciale mes vëllezërve, por unë jam zviceran dhe për mua si trajner kjo është një lojë normale kundër një ekipi shumë të mirë. Sot është një lojë përgatitëse për Kampionatin Evropian. Ne do të luajmë kundër një ekipi të mirë, me shumë përvojë që ishte edhe në Francë (Kampionatin Evropian).

A janë të motivuar lojtarët me fanellën e Kosovës, sepse kanë pasur një fazë të vështirë në kualifikimet e Botërorit?

Chalandes: Duhet të relativizojmë, pjesëmarrja e parë në histori me Kroacinë, Turqinë, Islandën, Ukrainën, si mund të prisnim të marrim shumë pikë nga këto ekipe. Nuk ka qenë keq, nuk ka qenë aq e thjeshtë, është shumë e qartë. Për një fazë të parë kualifikuese, për një ekip të ri nacional nuk ka qenë aq keq. Nëse marrim vetëm rezultatet, vetëm një pikë, mund të themi, po, nuk ishte mirë. Ky është një proces dhe ne duhet të kemi durim. Unë ndërroj të kualifikohem për Kampionatin Evropian, unë të arrij gjithçka me ekipin e Kosovës, por ne jemi Kosova dhe pas dy pjesëmarrjeve për kualifikim të arrijmë menjëherë një qëllim të këfillë, në Evropë, me 26 ekipe. Mirëpo në futboll është gjithçka e mundur, ne duhet të besojmë, duhet të ndërrojmë dhe unë po e bëj këtë, por e di që durimi nuk është cilësia e parë e njerëzve.

A ka Kosova infrastrukturë sportive për ekipin kombëtar?

Chalandes: Ne duhet të përmirësohemi çdo ditë. Jemi një fëmijë dhe duhet të mësojmë të rritemi. Në kampionat, për shembull, nuk ka ende një infrastrukturë të mirë, por kjo është normale. Kosova është vetëm 10 vjet e vjetër. Kur shohim ekipin e Prishtinës që luan në Pejë, kjo është e pabesueshme për mua. S'ka stadium, s'ka fushë në Prishtinë për Prishtinën. Si është kjo e mundur, por sot është kështu dhe ne duhet të punojmë që nesër të bëhet më mirë. Ky është një zhvillim normal edhe për të gjitha klubet dhe përgatitjen e të rinjve, trajnerëve, fushave, infrastrukturës. Për mua kjo nuk ka qenë një befasi. Jemi të rinj e duhet të punojmë dhe Federata është gati për këtë.

Si e keni ndjerë veten në Kosovë?

Chalandes: Ndjenja ka qenë pozitive, njerëzit jetojnë, vendi ka gjallëri. Nëse shëtit në qendër të Prishtinës, sheh se të rinjtë, shumë të rinj janë aty, janë në rrugë, ata jetojnë.

Si keni komunikuar atje, si flisni me lojtarët?

Chalandes: tani të gjithë të rinjtë flasin nga pak anglisht dhe me lojtarët flas më tepër anglisht, pastaj gjermanisht apo frëngjisht.

Cilat janë synimet e Kosovës në Ligën e Kombeve?

Chalandes: S'ka synime, ne duam ta fitojmë grupin tonë. Nuk funksionoj kështu si trajner. Kjo është budallaki. Objektivat janë të ndërtojmë një ekip që luan mirë e që përmirësohet lojë pas loje. Unë nuk e di a mjafton kjo në fund për ta fituar grupin, por duhet gjithnjë të përmirësohemi e të luajmë më mirë. Ky është objektivi, të ndërtojmë një ekip të vërtetë e të krijojmë një familje brenda ekipit.

Clevelandi, kampion në Konferencën e Lindjes

OHIO, 28 MAJ - Cleveland Cavaliersi ka fituar finalen e "play-off"-it kundër Boston Celticsit, duke u shpallur kampion në Konferencën e Lindjes. Një sfidë e çmendur, ashtu siç edhe pritej nga rivaliteti dhe emocionet që do të sillte. Nuk ka zhgënjyer i jashtëzakonshmi

LeBron Jamesi, që ka udhëhequr skuadrën drejt një fitoreje me rezultatin 87-79, duke shkuar për të 9-n herë në karrierën e tij në finalen e "play-off"-it. Ai ka qenë i papërmbyshëm në parket, duke realizuar në këtë ndeshje finale të shtatë në Lindje, 35 pikë, 15 rebounde dhe

9 asistime. Një ndeshje ku nuk ishte e lehtë të shënoje dhe ku mbrojtjet ishin të vështira për t'u çarë e depërtuar, por jo për LeBronin, që realizoi i vetëm një të tretat e pikëve të skuadrës së tij. Mirë u paraqitën edhe Greeni (19 pikë), Smithi (12 pikë) e Thompsoni (10), ndërsa për

Bostonin nuk mjaftuan 24 pikët e Tatumit për ta evituar këtë humbje. Skuadra e Celticsit humbi një shans të artë për të shkuar në finalen e mëdha, por mungesa e Irvingut në fazën e "play-off"-it, i dëmtuar që në prill, u ndje shumë, pasi mungoi përvoja e tij në parket.





					Autor: GAZMEND MORINA	KRYEQYTETI I SENEGALIT	KËNGËTARJA E FAMSHME SKOCEZE NË FOTO (shqip.)	MBARËSI	SHTET NË EVROPË (pashq.)	SHPEND UJI SHTEGTAR	KRYEHOXHË	KËMISHË E THJESHTË PREJ PËLHURË TË BARDHË (shq.)	EPOKA E RE	ZVOGËLIM I TEPËRT	TRAJNERI GJERMAN REHAGEL	QË PRODHOHET NË SERI	
							○						SUPER MODELJA KATE ...				
							○						INSTITUTE TECHNICAL EDUCATION				
							○						ARBOR (perkdh.) PAKTI USHTARAK MË I MADH NË BOTË				
							○	PORTI DETAR SPIUNIA E NJOHUR ... HARI						ZANORE SHALQI			
							○			AKTORJA AMERIKANE LINDA	POLITIKANI DOKLE MINUTA (krah.)						
							○		BOTIM ALEN NURI							LLOJ VETURE JAPONIZE	
					EPOKA E RE	KRYEQYTETI KANADEZ "N" pas dy "I"	○						GAZ PËR TË PASTRUAR MIRË PLAGËT SMALTI				
EPOKA E RE	I UJITA	ANJATA	GRIMCA MOLEKULARE	THEMBRA E KËPUCËS NGASËSI I "FORMULA 1" HAKINEN	FRIKAKAKE DEUT MUZIKOR KONTROVERS (fem.)	○								LUMË NË AUSTRI			
I PËSHPËRIT DIKUJT FJALË MAGJIKE						○	MOTAKU	MINDER POROSITË E FUNDIT PARA VDEKJES						FEMËR E ZGJEDHUR ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHERINGAM			
SHTETI MË I VOGËL NË BOTË						○		MBULESAT QË VIHEN NË FYTYRË AKTORJA E FAMSHME REID						DEM AKTORI FLLOKO			
JURIST QË JEP NDIHMË E KËSHILLA PËR ÇËSHITJE TË DREJTËSISË						○	AKTORI ... HANKS DY BASHKË-TINGËLLORE			MJET PUNE VOZË E DJATHIT					NANCY NJË NGA PERIMET KRYESORE TË VJESHTËS		
FEMRA QË VALLËZON ME NJË KAVALIER				LUTJET NË TË CILAT PRIFTI SHPREH DISA DËSHIRA OREKSI		○				JETË E QETË PUBLICISTI SHKËLZEN						AKTORI FRANCEZ ... RENO (shqip.)	
INTENSITET, TITAN				ZANORE LETRARI ZOLA	CMENDJE PIANISTJA LULE	○							PAMJE, FIGURË QË MISHËRON DICKA ANIJE E MADHE E FUNDOSUR				
TONI ADAMS			ELVIS PRESLEY ENTERPRISES NJË PREJ FIGURAVE STILISTIKE			○	FUSHËBET-EJAT NDERIMI QË I BËHET MYSAFIRIT (arab.)							NJËSI E VJETËR PESHE AKTORI TURK IMIRZALIOGLU			
ZANORE		BAR PËR TË DALË JASHTË (shq.) RRETHI QË VIHET SI STOLI NË GISHT				○		SFOND SHKRONJASH KËNGËTARJA VENERA							DY BASHKË-TINGËLLORE QË KA KARAKTERIN E NJË MITI		
EPOKA E RE	BASHKIMI I FORTË KËNGËTARJA KANADEZE MORISSETTE					○		SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE ORGANIZATË SEPARATISTE NË SPANJË									BROSHURA ME PËRMBAJTJE POLITIKE TË KOHËS DHE QË NGJITET NË MURË
ZBËRTHIM I NJË ÇËSHITJE (sh.shq.)						○				GAZETARI MEHMEDI KURESHTJE						BASHKËT. OTOMAN	
LEGAL ASSISTANCE FOUNDATION				RRAFSHNALTË E MADHE NË AZI LLOJI, SOJI		○				XEHETAR SHKRONJË GREKE							
NITROGJENI					BANORE E ARABISË SAUDITE LETRARI ... ALIU	○								I FILLOVA AKTORJA E VJETËR ... RINA			
SHEGA					FLORIRI ERMELINDA MEKSI	○		KITARISTI I FAMSHËM KLEPTON DY BASHKË-TINGËLLORE							KOTAHI MANO KAÏKA DY BASHKË-TINGËLLORE		
ZANORE		THIRRJA QË I BËHET TURMËS SË NJERËZVE SIENA				○		AKTI MË I LARTE JURIDIK QË NJJERRIN KOMUNAT NË KOSOVË PRAGA								ARTIOLA TOSKA ARMENIA	
STERJO SPASSE			PËREMËR PRONOR			○	GRUAJA E MOSHUAR						ISH DIZENJATORI ... VERSAÇI				



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

04 Drejtoria e Arsimit
Nr. 111-3735 /2018
Klinë, 28/05/2018

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1 i Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.72/2010), nenit 34, paragrafi 5 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar nr.04/L-032, nenit 5, pika C e Ligjit për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 2, pika 2 e UA nr.08/2014 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues, Drejtori i Drejtorisë për Arsim shpall:

KONKURS PUBLIK PËR

Drejtore të institucioneve edukativo-arsimore.

- SHFMU " Nena Tereze Budisalc, numër referencë: JP00033396

Koeficienti i pagës: 7.8

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të shkollës:

- Menaxhimi dhe administrimi i përgjithshëm i institucionit shkollor,
- Hartimin e planeve vjetore të punës dhe planin zhvillimor të shkollës,
- Koordinimi i punës me Këshillin e shkollës, aktivet profesionale dhe organet tjera qeverisë në shkollë,
- Detyrat dhe obligimet që dalin në bazë të plan programit mësimor aktual,
- Ruajtja e dokumenteve dhe të dhënave ashtu si parashihet në Ligjin e arsimit dhe në aktet normative,
- Monitorimin e orëve mësimore,
- Vlerësimin e performancës së mësimit dhe stafit tjetër administrativ dhe teknik,
- Planifikimin e buxhetit të shkollës dhe menaxhimin sipas kërkesave;
- Ruajtjen e dokumentacionit financiar dhe llogaridhënia për shpenzimet buxhetore,
- Pjesëmarrjen në panelin për pranimin e kuadrit në shkollë,
- Nxjerrjen e vendimeve për themelimin e komisioneve të ndryshme në interes të shkollës,
- Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga ana e DKA-së dhe obligimet e përcaktuara me akte të tjera normative.

Për të gjitha pozitat:

Mbikëqyrësi: Drejtori i Drejtorisë së Arsimit
Orari i punës: 40 orë
Kohëzgjatja e Emërimit: Emërimi është me mandat 4 vjeçar.

Shkollimi i kërkuar për pozitat e kërkuara:

- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor 4 vjeçar, 240 ECTS.
- Të kenë diplomë Universitare nga profilet arsimore të pranueshme për pozitën e mësimit dhe sipas Udhëzimit për licencimin e mësimit dhe sipas normativit për Kuadrin mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore.
- Të ketë licencë të rregullt për mësimit ose të jenë në përfundim të procedurës së licencimit.

Përvoja, aftësitë dhe cilësitë e tjera:

- Së paku tri (3) vite përvojë pune në arsim.
- Të kenë të përfunduar me sukses një nga programet e akredituara të kualifikimeve profesionale për udhëheqje, administrim ose menaxhim të institucioneve edukative – arsimore.
- Njohuri lidhur me ligjet, rregulloret e aplikueshme në fushën e arsimit dhe njohuritë lidhur me dokumentacionin shkollor dhe pedagogjik të nxënësve.
- Shkathtësi në komunikim, planifikim dhe koordinim të punës së personelit në nivel të shkollës.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve e këshillave profesionale.
- Shkathtësi në komunikimin elektronik, kompjuterik në aplikacione të programeve (Word, Excel, Pwer Point, Access etj).

Dokumentet e nevojshme:

- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe kopja e letërnjoftimit);
- Diploma e kualifikimit e noterizuar;
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT,
- Dëshmia e licencës së mësimit (vendimi dhe licenca), ose dëshmia që është në procedurë të licencimit,
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim,
- Portfolio profesionale (sipas udhëzimeve në shtojcën G të UA nr 08\2014)
- Letër-referencë nga një institucion publik kredibil si MASHT-i, DKA-ja, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak ose nga institucionet e arsimit të lartë. Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimin paraprak.
- Plan zhvillimor i institucionit edukativ arsimor dhe aftësues për të cilin konkurron (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5 dhe me font të shkronjave Arial, madhësia 11, sipas udhëzimeve të MASHT-it.
- Certifikata shëndetësore e lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore e kandidatit.
- Dëshmia se kandidati nuk është nën hetim.


Mënyra e Aplikimit:

Formularët për aplikim merren në Drejtorinë e Arsimit dhe dorëzohen po në të njëjtën drejtori. Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni në Drejtorinë e Arsimit direkt ose përmes telefonit fiks 03820043727.

Konkursi mbetet e hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik. Dokumentet e pakompletuara dhe pas afatit nuk pranohen.

Ligji i Shërbimit Civil ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore si dhe nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Drejtori i DKA-së
Arben Limanaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

04 Drejtoria e Arsimit
Nr. 111-3735 /2018
Klinë, 28/05/2018

Na osnovi clana 11, stav 1 Zakona Civilne Sluzbe Kosova broj 03/L-149 (Sluzbeni List Republike Kosova 72/2010), clana 34, stav 5 Zakona o Predunivestetskoj Obrazovanja 04/L-032, clana 5, tacka C Zakona Obrazovanja u Opstinama Republike Kosova 03/L-068, clana 2, tacka 2 AU br.08/2014 o postupcima i uslovima izabranja direktora edukativnih-obrazovnih institucija, Direktor Odeljenja Obrazovanja objavlja:

JAVNI KONKURS

za

Direktore edukativno-obrazovnih institucija kao sledece:

- NOSŠ " Nena Treze, broj ref: JP00033396

Koeficient plate: 7.8

Duznosti i odgovornosti:

- Rukovodjenje i administriranje skole,
- Priprema godisnjih planova rada i razvojnog plana skole,
- Sradjivanje sa savetom skole, profesionalim aktivimam i ostalim telima skola,
- Sacuvanje raznih dokumenata i podataka predvidjeno zakonom i ostalim normativnim dokumentima,
- Nadgeladavanje obrazovnih casova,
- Ocenivanja performanse nastavnika i ostalih radnika skole,;
- Planiranje i upravljanje budzetom skole;
- Sacuvanje finansiskoh dokumenata i davaje odgovornosti o troskovima,
- Ucesce u panelu za prijem skolskog kadra,
- Uzimanje odluka za osnivanje raznih komisija za interes skole,
- Ostale zadatke date od OOO u skladu sa vazecom normativom.

Broj referencije direktora NOSŠ-ve: JP00029398

Za sve pozicije:

Nadzornik: Direktor Odeljenja za Obrazovanje
Radno Vreme: 40 sati
Rok Imenovanja: 4 godisnji mandat

Obavezno skolovanje:

- Minimum 4 godisnji universitetski nivo i uz 240 ECTS.
- Univezitetska diploma za nastavnike na osnovi upustva o licensiranju obrazovnog kadra.
- Regularna licenca za obrazovanje ili pri kraju licensiranja.

Iskustvo, sposobnosti i ostalo:

- Najmanje 3 godine iskustva u obrazovanju.
- Najmanje jedno od akreditiranih profesionalnih programa za upravljanje, administriranje ili rukovodjenje obrazovnim institucijama.
- Znanje o zakonima i regulativom oko obrazovanja kao i o skolskom i pedagogskom dokumentaciji ucenika.
- Znanje o komuniciranju, planiranju i koordiniranu rada kadra skole.

Trazeni dokumenti:

- Licni dokumenti (izvod rođenja i kopija licne karte);
- Noterizovana diploma skolovanja;
- Dokaze o obukama akreditirane os MONT,
- Dokaz licensiranja kao nastavnik ili dokaz da licensiranje je u toku,
- Dokaz iskustva,
- Profesionalni portfolio (na osnovi upustva aneksa G AU br 08\2014)

- Referentno nismo od krediblen javne institucije ud dokaz o prethodnom iskustvi i sposobnostima.
- Razvoji plan skolske institucije za koju konkurise (najmanje 10 stranice, razmak redova 1.5, slova Arial, velicina 11, po upustvima MONT),

Način konkurisanja:

Formulari za prijavu mogu se dobiti u Opštinskoj odeljenji obrazovanja i predaju se takodje u istoj odeljenji. Za detaljnije informacije možete kontaktirati odeljenje obrazovanja direktno ili preko telefona 03820043727.

Rok konkurisanja je 15 dana od dana objavljivanja u sredstvima javnog informisanja. Nepotpuni dokumenti kao i oni predati posle roka neće se prihvatiti. Predati dokumenti se ne vracaju.

Civilna Sluzba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republika Kosova i pozdravlja aplikacije muškog i ženskog pola kao i svih zajednica na Kosovu.

Direktor Odeljenja Obrazovanja
Arben Limanaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOSŁJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 03/L - 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës shpall:

K O N K U R S

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar për Shërbime të Punësimit në ZP – Suharekë (një pozitë)

Referenca: RN00003265

Institucioni: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

Lloji i pozitës: I karrierës

Tipi i Akt Emërimit të punës: Orar të plotë pune

Titulli i mbikëqyrësit: Udhëheqës i Zyrës së Punësimit

Kategoria funksionale: Niveli Profesional

Grada/Koeficienti: Koeficienti – 6.5

Procedura e aplikimit: I jashtëm

Vendi: Suharekë

Qëllimi i vendit të punës: Bëhë vlerësimin e nevojave të të papunësuarve dhe punëkërkuessve dhe siguron këshilla dhe informacione sipas nevojave të tyre për të ndihmuar të gjejnë punë; njëkohësisht ofron këshilla dhe informacione për punëdhënësit që kërkojnë punëtorë ose ndihmë tjetër lidhur me rekrutim dhe bën ndërmjetësimin në punësim.

Detyrat dhe përgjegjësitë krvesore:

1. Identifikon vështirësitë kryesore të të papunësuarit për punësim, interviston dhe regjistron klientët në SIMP.
2. Ofron këshillim (për punësim, për karrierë ose këshillim intensiv), informacione dhe ndihma të tjera për të papunësuarit dhe punëkërkuessit, varësisht nga vështirësitë kryesore të tyre për punësim.
3. Orienton të papunësuarit në aftësim profesional dhe në masat e tjera aktive të tregut të punës, sipas nevojave të klientit dhe sipas kritereve të masave të specifikuar në dokumentet kyçe.
4. Kontakton dhe organizon vizita në biznese dhe subjekte tjera, respektivisht, te punëdhënësit në mënyrë të rregullt për të promovuar shërbimet e ZP-së dhe PATP-së por edhe për të grumbulluar të dhëna për vende të lira të punës.
5. Kryen regjistrimin e punëdhënëscve të interesuar për të bashkëpunuar me ZP-në në SIMP dhe mban komunikimin me ta.
6. Ndërmerr procesin e ndërmjetësimin në përputhshmëri me kërkesat dhe orienton klientët tek ofertat e përshatshme të punës ose mundësitë për masat aktive të tregut të punës.
7. Përcjell procesin e aplikimit të kandidatëve dhe ofron shërbime cilësore para zgjedhjes së kandidatëve për intervistë dhe shërbime për përzgjedhjen finale të kandidatëve për rekrutim me kërkesën e punëdhënësit.
8. Ndihmon klientët të kompletojnë format e aplikacionit dhe konkludon marrëveshjen formale/MM mes palëve për masat aktive të tregut të punës dhe bën përcjelljen e pjesëmarrësve.
9. Organizon vizita monitoruese për të mbikëqyrë implementimin e skemave dhe bën procesimin e të gjithë dokumentacionit për kryerjen e suksesshme të skemës.
10. Rishikon realizimin e aktiviteteve që dalin nga këshillimi ose nga Plani Individual i Punësimit, motivon klientin gjatë tërë periudhës sa është në kërkim të punës dhe ofron mbështetje gjatë ndërmarrjes së veprimeve të specifikuar.
11. Ofron shërbime tjera sipas udhëzimeve, politikave të definuara nga MPMS-ja dhe Agjencia.

Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë e tjera:

- Diplomë universitare nga fushat e shkencave ekonomike, juridike dhe sociale;
- Dy vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri lidhur me tregun e punës, shkathtësitë e kërkuara në treg, vendet e lira të punës dhe kërkesat për të hyrë në ato vende punë;
- Aftësi për të punuar si pjesë e ekipit dhe shkathtësi të mira të zgjidhjes së problemeve;
- Shkathtësi të mira interpersonale dhe aftësi të komunikimit efektiv (me gojë dhe me shkrim) me klientët (të papunësuarit, punëkërkuessit dhe punëdhënësit)
- Mendjehapur dhe gatishmëri për të marrë në konsideratë idetë dhe opsionet e reja.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike dhe të vlerësimit të informacionit;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point);

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar për Shërbime të Punësimit në ZP – Podujevë (një pozitë)

Referenca: RN00003266

Institucioni: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

Lloji i pozitës: I karrierës

Tipi i Akt Emërimit të punës: Orar të plotë pune

Titulli i mbikëqyrësit: Udhëheqës i Zyrës së Punësimit

Kategoria funksionale: Niveli Profesional

Grada/Koeficienti: Koeficienti – 6.5

Procedura e aplikimit: I jashtëm

Vendi: Podujevë

Qëllimi i vendit të punës: Bëhë vlerësimin e nevojave të të papunësuarve dhe punëkërkuessve dhe siguron këshilla dhe informacione sipas nevojave të tyre për të ndihmuar të gjejnë punë; njëkohësisht ofron këshilla dhe informacione për punëdhënësit që kërkojnë punëtorë ose ndihmë tjetër lidhur me rekrutim dhe bën ndërmjetësimin në punësim.

Detyrat dhe përgjegjësitë krvesore:

1. Identifikon vështirësitë kryesore të të papunësuarit për punësim, interviston dhe regjistron klientët në SIMP.
2. Ofron këshillim (për punësim, për karrierë ose këshillim intensiv), informacione dhe ndihma të tjera për të papunësuarit dhe punëkërkuessit, varësisht nga vështirësitë kryesore të tyre për punësim.
3. Orienton të papunësuarit në aftësim profesional dhe në masat e tjera aktive të tregut të punës, sipas nevojave të klientit dhe sipas kritereve të masave të specifikuar në dokumentet kyçe.

4. Kontakton dhe organizon vizita në biznese dhe subjekte tjera, respektivisht, te punëdhënësit në mënyrë të rregullt për të promovuar shërbimet e ZP-së dhe PATP-së por edhe për të grumbulluar të dhëna për vende të lira të punës.
5. Kryen regjistrimin e punëdhënëscve të interesuar për të bashkëpunuar me ZP-në në SIMP dhe mban komunikimin me ta.
6. Ndërmerr procesin e ndërmjetësimin në përputhshmëri me kërkesat dhe orienton klientët tek ofertat e përshatshme të punës ose mundësitë për masat aktive të tregut të punës.
7. Përcjell procesin e aplikimit të kandidatëve dhe ofron shërbime cilësore para zgjedhjes së kandidatëve për intervistë dhe shërbime për përzgjedhjen finale të kandidatëve për rekrutim me kërkesën e punëdhënësit.
8. Ndihmon klientët të kompletojnë format e aplikacionit dhe konkludon marrëveshjen formale/MM mes palëve për masat aktive të tregut të punës dhe bën përcjelljen e pjesëmarrësve.
9. Organizon vizita monitoruese për të mbikëqyrë implementimin e skemave dhe bën procesimin e të gjithë dokumentacionit për kryerjen e suksesshme të skemës.
10. Rishikon realizimin e aktiviteteve që dalin nga këshillimi ose nga Plani Individual i Punësimit, motivon klientin gjatë tërë periudhës sa është në kërkim të punës dhe ofron mbështetje gjatë ndërmarrjes së veprimeve të specifikuar.
11. Ofron shërbime tjera sipas udhëzimeve, politikave të definuara nga MPMS-ja dhe Agjencia.

Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë e tjera:

- Diplomë universitare nga fushat e shkencave ekonomike, juridike dhe sociale;
- Dy vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri lidhur me tregun e punës, shkathtësitë e kërkuara në treg, vendet e lira të punës dhe kërkesat për të hyrë në ato vende punë;
- Aftësi për të punuar si pjesë e ekipit dhe shkathtësi të mira të zgjidhjes së problemeve;
- Shkathtësi të mira interpersonale dhe aftësi të komunikimit efektiv (me gojë dhe me shkrim) me klientët (të papunësuarit, punëkërkuessit dhe punëdhënësit). Mendjehapur dhe gatishmëri për të marrë në konsideratë idetë dhe opsionet e reja.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike dhe të vlerësimit të informacionit;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point);

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave (një pozitë)

Referenca: RN00003267

Institucioni: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës/ Divizioni për Burime Njerëzore;

Lloji i pozitës: I karrierës

Tipi i Akt Emërimit të punës: Orar të plotë pune

Titulli i mbikëqyrësit: Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore

Kategoria funksionale: Niveli Profesional

Grada/Koeficienti: Koeficienti – 7

Procedura e aplikimit: I jashtëm

Vendi: Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Monitorimi i mediave të shkruara dhe elektronike, përgaditja e përmbledhjeve për menaxhmentin e Agjencisë dhe përgaditja e përgjigjeve për media.

Detyrat dhe përgjegjësitë krvesore:

1. Është përgjegjës për sigurimin e ndërlidhjes së APRK – së me mediat;
2. Përcjell shkrimet dhe publikimet e mediave lidhur me punën e Agjencisë dhe përgadit përgjigjet sipas nevojës;
3. Monitoron në vazhdimësi shkrimet e mediave lidhur me aktivitetet e Agjencisë dhe përgadit raporte për menaxhmentin e Agjencisë;
4. Mban dhe përditëson një bazë të të dhënave të mediave dhe krijon kontaktet me media;
5. Përgadit kumtesa, informata, raporte dhe publikime për aktivitetet e Agjencisë;
6. Mirëmban, ruan dhe arkivon të gjitha kumtesat, informatat, raportet dhe publikimet tjera për publikun
7. Siguron zbatimin e standardeve për komunikim me publikun
8. Kryen dhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt apo menaxhmenti i Agjencisë.

Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë e tjera:

- Diplomë universitare në gazetari, komunikim masiv ose gjuhë dhe letërsi
- Dy vite përvojë pune profesionale
- Njohuri në fushën e gazetarisë dhe komunikimit masiv
- Shkathtësi të mira komunikuese
- Shkathtësi hulumtuese, analitike dhe vlerësuese;
- Shkathtësi kompjuterike për aplikacionet të programeve (WORD, EXCEL, POWER POINT)

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor, nga data 29.05.2018 deri më 12.06.2018.

Formularët për aplikim merrren në Divizionin për Burime Njerëzore/APRK, rruga Bekim Fehmiu nr 127, zyra nr 21, dhe të plotësuara dorëzohen në Divizionin për Burime Njerëzore/APRK, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00.

Aplikacionet e dërguara me postë të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme nëse arrijnë brenda katër (4) ditësh.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën e punës dhe dokumente të tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale për verifikim para komisionit intervistues.

Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim në afat ligjor nga Divizioni i Burimeve Njerëzore.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOŠLJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Na osnovu člana 18 Zakona Br.03/Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova, Poslovnika Br.02/2010 o Procedurama Rekrutovanja u Civilnoj Službi, Agencija za Zapošljavanje Republike Kosovo:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Službenik za Službu Zapošljavanja u KZ- Suva Reka (jedna pozicija)

Referencija : RN00003265

Institucija: Agencija za Zapošljavanje Republike Kosovo

Vrsta pozicije: Karijere

Vrste imenovanja: Puno radno vreme

Naziv nadzornog : Rukovodioc Kancelarije za Zapošljavanje

Funkcionalna kategorija: Profesionalni Nivo

Grad / Koeficijenti: Koeficijent - 6.5

Procedura aplikacije: Spoljni

Lokacija: Suva Reka

Svrha posla: Procenjuje potrebe nezaposlenih i posao tražilaca i pruža savete i informacije prema njihovim zahtevima za pomaganje u pronalazku posla ; Istovremeno, pruža savete i informacije poslodavcima koji imaju potrebu za radnike ili drugu pomoć vezanu za zapošljavanje i posredovanje u zapošljavanju.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

1. Identifikovati glavne poteškoće nezaposlenih, za intervju za zapošljavanje, intervistiranje i registruje klijente u SIMP .
2. Pružanje saveta (za zapošljavanje, karijeru ili intenzivnog savetovanja), informacije i drugu pomoć za nezaposlene i posao tražioce, u zavisnosti od njihovih glavnih poteškoća za zapošljavanje.
3. Usmerava nezaposlenih u stručnoj obuci i drugih aktivnih mera na tržištu rada, u skladu sa potrebama klijenata i prema kriterijumima utvrđenim mere u ključnim dokumentima.
4. Kontaktira i organizuje posete preduzećima i drugim subjektima, odnosno, redovno poslodavaca da promovišu usluga KZ i PATR, da prikupljaju podatke o slobodnim radnim mestima.
5. Izvršiti registraciju zainteresovanih poslodavaca da saraduju sa KZ-u SIMP i održava komunikaciju sa njima.
6. Obavlja proces posredovanja u skladu sa zahtevima i usmerava klijente na odgovarajućim ponude za posao ili mogućnosti za aktivne mere na tržištu rada.
7. Praca proces prijavlivanja kandidata i pruža kvalitetne usluge pred izbor kandidata za intervju i usluga za konačni izbor kandidata za zapošljavanje poslodavci tražnje.
8. Pomaže klijentima da kompletiraju oblike aplikacije i zaključuje formalan / MM Sporazum između strana o aktivnim merama tržišta rada i provodi prisutne.
9. Organizuje nadzorne posete za nadgledanje implementacije šema i obrađuje svu dokumentaciju za uspešnu implementaciju šeme.
